



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Strategjia e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor (SZHSKS) 2020 - 2030

Dhjetor 2019

Përmbajtja

1	Konteksti.....	1
2	Vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor	3
2.1	Plotësimi i nevojave të përdoruesve	3
2.1.1	Indikatorët për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020.....	3
2.1.2	Zbatimi i acquis communautaire për statistikën.....	3
2.1.3	Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore për statistika	4
2.1.4	Të dhënat mikro (Mikrodata)	4
2.1.5	Angazhimi me përdoruesit/procesin këshillues	5
2.1.6	Shpërndarja e statistikave	6
2.1.7	Ndërgjegjësimi dhe mbrojtja statistikore	6
2.2	Çështje të prodhimit statistikor	7
2.2.1	Burimi i të dhënave.....	7
2.2.2	Grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe analizimi	8
2.2.3	Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare	9
2.2.4	Çështje të cilësisë	9
2.2.5	Metadata.....	10
2.3	Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ.....	11
2.3.1	Kuadri ligjor.....	11
2.3.2	Kuadri institucional dhe qeverisja.....	12
2.3.3	Strukturat organizative.....	13
2.3.4	Praktikat menaxhuese.....	14
2.4	Çështje të sistemit.....	15
2.4.1	Qëllimi i Sistemit Kombëtar Statistikor	15
2.4.2	Koordinimi	16
2.4.3	Besueshmëria të statistikave.....	16
2.4.4	Konfidencialiteti	17
2.4.5	Roli i Partnerëve për Zhvillim.....	18
2.5	Burimet.....	18

2.5.1	Personeli, trajnimi dhe zhvillimi	18
2.5.2	Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.....	21
2.5.3	Infrastruktura statistikore	22
2.5.4	Buxheti për statistikat	22
2.5.5	Financimi për statistikat.....	23
2.6	Analiza SWOT	23
3	Vlerësimi i institucioneve statistika-prodhues.....	25
3.1	Plotësimi i nevojave të përdoruesve	25
3.1.1	Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave.....	25
3.1.2	Statistikat e disagreguara (statistikat lokale dhe disagregime të tjera)	25
3.1.3	Shpërndarja e të dhënave	25
3.2	Çështje të prodhimit të statistikave.....	26
3.2.1	Burimi i të dhënave.....	26
3.2.2	Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave.....	26
3.2.3	Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare	26
3.2.4	Çështje të cilësisë	26
3.2.5	Metadata.....	26
3.3	Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ.....	27
3.3.1	Kuadri ligjor.....	27
3.3.2	Funksionet dhe strukturat organizative	27
3.4	Çështje të sistemit.....	27
3.4.1	Konfidencialiteti	27
3.4.2	Roli i Partnerëve për Zhvillim.....	27
3.5	Burimet.....	28
3.5.1	Personeli, trajnimi dhe zhvillimi	28
3.5.2	Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.....	28
3.5.3	Infrastruktura statistikore	29
3.6	Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet	29
3.7	Të dhëna administrative në dispozicion.....	29
4	Vlerësimi i institucioneve që janë ofrues të të dhënave administrative për qëllime statistikore	31
4.1	Plotësimi i nevojave të përdoruesit	31
4.1.1	Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore për statistika.....	31

4.1.2	Statistikat e disagreguara (statistikat lokale dhe disagregime të tjera)	31
4.1.3	Shpërndarja	31
4.2	Çështje të prodhimit të statistikave	32
4.2.1	Burimi i të dhënave.....	32
4.2.2	Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare	32
4.2.3	Çështje të cilësisë	32
4.2.4	Metadata.....	32
4.3	Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ.....	32
4.4	Çështje të sistemit.....	33
4.4.1	Konfidencialiteti	33
4.4.2	Roli i Partnerëve për Zhvillim.....	33
4.5	Burimet.....	33
4.5.1	Personeli, trajnimi dhe zhvillimi	33
4.5.2	Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.....	33
4.6	Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet	33
5	Kuadri Strategjik i propozuar për SZHSKS	35
5.1	Misioni.....	35
5.2	Vizioni.....	35
5.3	Vlerat.....	35
5.4	Objektivat	36
5.5	Nën-objektivat dhe Strategjitë	36
5.6	Efiçenca në kosto.....	40
6	Menaxhimi i SZHSKS-së	41
6.1	Mbulim i plotë.....	41
6.2	Sigurim i mbështetjes së vazhdueshme	41
6.3	Menaxhimi i SZHSKS-së	41
6.3.1	Bordi Këshillues.....	41
6.3.2	Ekipi i menaxhimit	42
6.3.3	Përbërja e IMRT.....	43
6.3.4	Zbatimi	43
6.3.5	Monitorimi dhe raportimi.....	43

6.3.6	Indikatorët e Performancës.....	44
6.3.7	Rishikimi dhe vlerësimi	48
7	Menaxhimi i Riskut	49
7.1	Risqet e identifikuara në analizën SWOT	49
7.2	Risqet shitesë	50
8	Shtojcat	53
8.1	Shtojca I: Rekomandime nga vlerësimet e Sistemit Kombëtar të Statistikave, prodhues të tjerë statistikash dhe mbajtësit e rekordeve administrative	53
8.2	Shtojca II: Procesi i Vlerësimit.....	58
8.3	Shtojca III. Referencat.....	60

Tabelat

Tabela 1 : Fondet në dispozicion për INSTAT-in.....	23
Tabela 2 : Indikatorët e performancës.....	45

Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
BSH	Banka e Shqipërisë
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DS	Departamenti i Statistikave
ESS	Sistemi i Statistikave Financiare
ESTP	Sistemi i Trainimit të Statistikave Evropiane
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Asistencën e Para-Anëtarësimit
IT	Informacioni dhe Teknologjia
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSA	Marrveshja e Stabilizim Asociimit
NID	Numrin Personal të Identitetit
NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKSZ	Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
RA	Rekorde Administrative
SMF	Statistikat Monetare Financiare
SKS	Sistemi Kombëtar i Statistikave
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SZhSKS	Strategjia për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar të Statistikave
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TP	Treguesit e Performancës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Kapitulli 1

Konteksti

Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor (SZHSKS) 2020-2030 është ndërmarrë në kontekstin e:

- mbështetjes së fuqishme nga qeveria shqiptare për zhvillimin statistikor;
- procesin e transformimit drejt integritimit në Bashkimin Evropian (BE);
- zbatimit të rekomandimeve të BE-së për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në Shqipëri sipas *acquis communautaire* (*acquis*) për statistikat;
- rritjen e vazhdueshme të kërkesës për sasi më të mëdha dhe cilësi të dhënash nga përdoruesit në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar për qëllime politikash, planifikimi dhe monitorimi;
- ndryshimeve të shpejta në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për statistikat; dhe
- Ligjit të ri Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, miratuar në 5 prill 2018 (Ligji për Statistikat 2018).

Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare (PSZ) 2017-2021¹ është në zbatim dhe përcakton strategjinë për zhvillimin e statistikave zyrtare dhe SKS-së për një periudhë pesëvjeçare; në këtë pikë kërkohet një dokument më afatgjatë planifikimi strategjik, për të plotësuar PSZ (2017-2021); rrjedhimisht, po zhvillohet edhe SZHSKS 2020-2030.

Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar planin vjetor për zbatimin e PSZ 2017-2021 përmes Vendimit të tij nr. 40/2019 “Për miratimin e Planit Vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021”.

Në rezolutën e tij të vitit 2019, Parlamenti i Shqipërisë ka rekomanduar (Rekomandimi nr. 5) hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me synim përmbushjen e rekomandimeve të Eurostat-it për forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe zbatimin e parimeve statistikore evropiane. Sipas kësaj rezolute, Parlamenti sugjeron krijimin e një plani konkret veprimi për zbatimin e kësaj Strategjie.

Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) dhe SKS kanë përfituar nga gjashtë procese vlerësimi - Vlerësimi Global 2010, Procesi i Vlerësimit të Kufizuar të Sistemit Statistikor “*Peer Review 201*” dhe “*Peer Review* rishikues 2015”, Analiza Sektoriale e statistikave të biznesit në 2015, Analiza Sektoriale e Anketës së Forcave të Punës në 2016, si dhe “*Peer Review 2018*”. Sugjerimet, udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna në këto vlerësime ishin instrumente të mira për të orientuar INSTAT-in në i) procesin e rishikimit të Ligjit për Statistikat, për ta bërë më mbështetës në zhvillimin statistikor dhe operacionet dhe në ii) prezantimin e një sërë përmirësimeve në statistika dhe procese statistikore. Pas vitesh zhvillimi të vazhdueshëm, shumica e veprimeve të rekomanduara për përmirësim janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, p.sh., në lidhje me *Peer Review 2018*, INSTAT ka përpiluar një plan të detajuar dhe gjithëpërfshirës për të zbatuar gjithë rekomandimet² dhe ka bërë

¹ Miratuar me vendim të Parlamentit nr. 10/2017, datë 09/02/2017

² Dokument i INSTAT-it “Rekomandimet e vlerësuesve *Peer review* dhe veprimet e përmirësimit të Institutit Shqiptar të Statistikave INSTAT në përgjigje të rekomandimeve”, Prill, 2019

hapa domethënës drejt përputhjes së plotë me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (CoP)³ dhe acquis⁴. SKS ka përmirësuar infrastrukturën dhe proceset e veta drejt të qenit në një linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Si rezultat i sa më sipër, është bërë e detyrueshme dhe e mundur që Sistemi Kombëtar Statistikor (SKS) të përcaktojë strategjitë e veta për të ecur dhe përfituar prej këtyre ndryshimeve drejt një rezultati të suksesshëm për përdoruesit e statistikave shqiptare. Këto janë përcaktuar edhe në këtë SZHSKS.

³ Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane për Autoritetet Statistikore Kombëtare dhe Komunitare, Përshtatur nga Komiteti Evropian i Sistemit të Statistikave, 28 shtator 2011

⁴ Peer Review 2018, fq 9

Kapitulli 2

Vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor

Ky vlerësim është bërë bazuar mbi një shkallë të gjerë karakteristikash të institucioneve të përfshira në prodhimin e statistikave ose furnizimin me të dhëna administrative (të cilave referohen gjithashtu edhe si rekorde administrative) si bazë për prodhimin e statistikave. Në shumë raste, janë dhënë rekomandime për veprim, të cilat janë paraqitur në Seksionin 8.1, Shtojca 1. Në kapitullin aktual paraqitet vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor (SKS).

2.1 Plotësimi i nevojave të përdoruesve

2.1.1 Indikatorët për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020

SKS nuk e kënaq plotësisht kërkesën për statistika në lidhje me monitorimin e SKZHI-së.

Në mënyrë tipike, strategjia kombëtare e zhvillimit të një vendi është një burim i rëndësishëm kërkesë për statistika, për qëllime monitorimi. Ky është dhe rasti në Shqipëri. SKZHI përfshin afërsisht 130 indikatorë monitorues. Indikatorët janë përmendur qartësisht. Përgjegjësia për çdo indikator i është caktuar një ministrie apo institucioni.

2.1.2 Zbatimi i *acquis communautaire* për statistikat

SKS ka bërë progres domethënës në zbatimin e *acquis* për statistikat.

Miratimi i Ligjit për Statistikat 2018 ishte një hap i rëndësishëm drejt përafrimit me standardet evropiane; ky miratim është në pajtim me Rregulloren 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian për Statistikat Evropiane. Ka pasur një sërë progres-raportesh vjetore të nxjerra nga BE që vlerësojnë progresin e bërë nga SKS në zbatimin e Nenit 88 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) (2006), nen i cili synon hartimin e një sistemi statistikor të qëndrueshëm dhe eficient, që të jetë në gjendje të ofrojë të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, të cilat nevojiten për planifikimin dhe monitorimin e procesit të tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Raportet janë nxjerrë në tetor 2014, nëntor 2015, nëntor 2016, prill 2018 dhe maj 2019 (në 2017 nuk doli raport).

Raportet i kanë cilësuar statistikat shqiptare duke u përmirësuar me kalimin e kohës. Raporti i vitit 2019 tregon se "Shqipëria është e përgatitur moderueshëm për statistikat. Janë bërë përparime në shumë fusha statistikore, si dhe nga miratimi i Ligjit të ri⁵ për Statistikat Zyrtare (Maj 2018) [...] Në lidhje me infrastrukturën statistikore, kuadri ligjor është në një linjë me atë të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe klasifikimet janë në një linjë me standardet e BE-së [...] Roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave (INSTAT) është fuqizuar..." Ky raport gjithashtu ka detajuar zhvillime pozitive dhe mangësira në fusha të ndryshme statistikore dhe ka identifikuar hapësirat për përmirësim. Gjithashtu, raporti arrin në përfundimin se buxheti i INSTAT-it dhe personeli vazhdon të jetë i pamjaftueshëm për zbatimin e tërësishëm të *acquis* së BE-së në fushën e statistikave.

⁵ Citimi i saktë i referohet Ligjit si "Ligji i ndryshuar....". Gjithsesi, teknikisht, Ligji për Statistikat Zyrtare (Maj 2018) nuk është një ligj "i ndryshuar", por një ligj i ri

Raportet kanë bërë rekomandime të cilat janë duke u zbatuar nga INSTAT. Gjithashtu, janë kryer⁶ edhe një sërë “Peer Reviews” që vlerësojnë zbatimin e Kodit të Praktikave Evropiane në Statistika dhe janë lënë rekomandime të cilat ndihmojnë drejt zbatimit të *acquis*. Po kështu, këto rekomandime janë duke u zbatuar.

Banka e Shqipërisë ka intensifikuar punën e vet për të përafuar metodologjinë e statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre me *acquis*.

Indikatorët për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ) statistikorë të OZHQ-ve dhe përditësimi i saj do të kryhet rregullisht. INSTAT ka krijuar një grup pune të brendshëm për OZHQ-të, i cili po hulumton hollësisht mundësitë e prodhimit të sa më shumë indikatorëve, duke u shtuar pyetje të reja anketave ekzistuese, duke parë mundësitë e përdorimit të të dhënave administrative dhe rritur bashkëpunimin me agjencitë mbajtëse të këtyre të dhënave dhe ministritë e linjës, përgjegjëse për indikatorë të veçantë.

2.1.3 Përbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore për statistika

SKS po përballlet me sfida madhore, që lindin nga nevoja për një set më të gjerë indikatorësh statistikorë; përveç kërkesave të veçanta të renditura në seksionet më sipër, ka edhe një numër në rritje të përdoruesve dhe rritje të përdorimit të statistikave nga grupi i përdoruesve kryesorë.

Kërkesat kanë ardhur në rritje për sasi, cilësi dhe disagregim më të madh të të dhënave nga përdoruesit në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar. Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve⁷ e INSTAT-it, e kryer në vitet 2017 dhe 2018, tregon (për vitin 2018): përqindje domethënëse të përdoruesve të cilët mendonin se të dhënat e INSTAT-it nuk përputheshin me nevojat e tyre për të dhëna (38.3% e përdoruesve në Anketën mbi Kënaqësinë e Përdoruesve e vitit 2017) dhe ata që ishin të pakënaqur me numrin e statistikave (25.4 % e përdoruesve në Anketën mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të 2018-ës).

INSTAT po punon për ndërtimin dhe forcimin e sistemit statistikor të Shqipërisë përsa i përket ofrimit të statistikave në nivel vendor,⁸ të nevojshme për vetëqeverisjen vendore për të hartuar politika zhvillimi dhe matje të performancës. Projekti “Statistika të Forta Lokale Shqiptare” (Projekti SALSTAT) është konceptuar për të mbështetur aktivitetet e zhvillimit në këtë fushë.

BSH raporton se nevojat e përdoruesve janë vazhdimisht në rritje dhe se po ushtrohet më shumë presion për një numër më të madh indikatorësh dhe të dhënash koherente. Megjithatë, BSH raporton se plotësohen kërkesat e përdoruesve.

2.1.4 Të dhënat mikro

Ashtu si INSTAT edhe BSH ofron akses në të dhënat mikro të anonimizuara për qëllime kërkimore-shkencore, duke përshtatur një politikë që është në përputhje me politikën aktuale në vende të tjera të Evropës.

INSTAT ofron akses në të dhënat mikro të anonimizuara për qëllime kërkimore-shkencore në përputhje me Nenin 31 të Ligjit për Statistikat, Rregulloren e INSTAT-it për “Aksesin në mikrodata” 2018 dhe “Politikën e

⁶ Shih nën Kreun 1 më sipër

⁸ Në mënyrë që të rritet cilësia e statistikave në nivel lokal dhe të zgjerohet shkalla e tyre, që prej vitit 2018 INSTAT ka firmosur projektin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës: Statistikat Lokale të Forta Shqiptare (Projekti SALSTAT).

Shpërndarjes së të Dhënave dhe Udhëzues", 2018. Konfidencialiteti i të dhënave individuale respektohet. INSTAT gjithashtu ofron akses në mikrodata (të dhënat mikro) sipas kërkesës.

BSH ofron akses në mikrodata (të dhënat mikro) me miratim paraprak nga Drejtori i Departamentit të Statistikës përmes një formulari të veçantë.

2.1.5 Angazhimi me përdoruesit/procesin këshillues

SKS zbaton një sërë praktikash të pranuar në lidhje me komunikimin me përdoruesit, median dhe botën akademike dhe ka plane të zgjeruara për ndërvëprimin me ta.

Përdoruesit

INSTAT këshillohet me përdoruesit e vet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë:

- Këshillimin me Këshillin e Statistikave (që është një organ përfaqësues i përdoruesve);
- Kryerjen çdo vit të anketave mbi kënaqësinë e përdoruesve, të cilat kanë filluar në vitin 2017;
- Zbatimin nga INSTAT të një Plan Veprimi për Angazhimin e Përdoruesve, bazuar në rezultatet e Anketave mbi Kënaqësinë e Përdoruesve, në Planin Vjetor të Strategjisë së Shpërndarjes së të dhënave dhe Komunikimit;
- Marrjen e mendimeve nga përdoruesit gjatë procesit të hartimit të PKSZ 2017-2021 dhe Planit Vjetor;
- Përdorimin gjerësisht të Facebook dhe Youtube si kanale komunikimi me përdoruesit; të dhënat e marra nga *Facebook insights* analizohen për të parë shtrirjen dhe popullaritetin e postimeve dhe klikimet mbi linqe.

BSH synon të monitorojë në mënyra të ndryshme rëndësinë e statistikave të saj në përmbushjen e nevojave të përdoruesve. Së pari, BSH ofron shpjegime të detajuara mbi aspektet e ndryshme të statistikave të veta, duke i vënë në dispozicion materialet e duhura në faqen e vet të internetit. Së dyti, në botimet e veta në faqen e internetit, BSH inkurajon sugjerime dhe komente për përmirësime në përmbajtjen e tyre dhe ofron edhe një adresë email-i, ku përdoruesit mund të drejtojnë pyetjet e tyre. Së treti, BSH kryen anketa për të identifikuar më së miri nevojat e përdoruesve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) këshillohet me përdoruesit rreth nevojave të tyre në një bazë *ad hoc*.

Media

INSTAT ka përcaktuar një politikë gjithëpërfshirëse në marrëdhënien me median në Udhëzuesin për Politikën e Shpërndarjes së të Dhënave të INSTAT-it 2018.

"Peer Review 2018" raporto⁹ se INSTAT ka një marrëdhënie të mirë me median dhe se INSTAT mban konferenca shtypi dhe punon fort për përfshirjen e medias në punën e tij. Një nga pozicionet në Këshillin e Statistikave i rezervohet një përfaqësuesi të medias. INSTAT mban të dhëna mbi numrin e herëve që përmendet në media, si një tregues i nivelit të interesit të medias për statistikën. Të dhënat tregojnë një numër domethënës të referimit.

⁹ Peer Review 2018, faqet 25, 26

Bota akademike

Është e qartë se INSTAT i jep rëndësi të veçantë bashkëpunimit me botën akademike dhe shkencore. Lidhjet e bashkëpunimit duket se janë të zhvilluara mirë. PKSZ 2017-2021 shprehet se një nga objektivat kryesore të statistikave kombëtare është të forcojë marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me organizatat kërkimore-shkencore dhe universitetet, dhe Plani Vjetor 2018 i INSTAT-it i referohet, si pjesë e rolit koordinues të INSTAT-it, “rritjes së bashkëpunimit me botën akademike dhe universitare për të rritur kapacitetet profesionale të statisticienëve”.

Këshilli i Statistikave tradicionalisht drejtohet nga një anëtar përfaqësues i botës akademike. Gjatë dy viteve të fundit, janë firmosur Memorandume Mirëkuptimi me pesë universitete. Në Memorandumin e Mirëkuptimit me Universitetin e Tiranës, INSTAT konfirmon mbështetje për planin e Fakultetit Ekonomik të këtij universiteti për të marrë pjesë në programin e Masterit Evropian për Statistikat Zyrtare, me nismë të Eurostat-it dhe Sistemit Evropian të Statistikave. Një pjesë e personelit të INSTAT-it mban diskutime apo leksione në universitete¹⁰.

2.1.6 Shpërndarja e statistikave

Shpërndarja e statistikave të SKS-së ndjek praktika ndërkombëtare të përditësuar; statistikat u shpërndahen siç duhet përdoruesve, duke përdorur një larmi formatesh që plotësojnë nevojat e tyre, duke përdorur teknologji moderne. SKS shpërndan statistika duke respektuar pavarësinë profesionale dhe në mënyrë objektive e transparente, duke ofruar publikim të njëkohshëm të të gjithë përdoruesit, si dhe duke mbrojtur konfidencialitetin.

Shpërndarja e të dhënave të INSTAT-it bëhet në përputhje me Politikën e Shpërndarjes së të Dhënave të Udhëzuesin, 2018 të INSTAT-it dhe e cila përputhet me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Udhëzuesi përfshin edhe politikën e publikimit dhe politikën mbi rishikimet, mbrojtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë, si dhe të drejtën e autorit. Udhëzimet shoqërohen me Strategjinë e Shpërndarjes së të Dhënave dhe Komunikimit, të cilat përcaktojnë një rrugë që duhet ndjekur për përmirësimin e kanaleve të komunikimit dhe ofron orientim për përmbajtjen që do të shpërndahet, përfshirë këtu edhe metadat.

INSTAT i shpërndan produktet e tij statistikore përmes një kombinimi të përshtatshëm të TIK modern, duke përfshirë edhe njoftimet dhe konferencat për shtyp, botimet (të gjitha botimet përkthehen në anglisht) të shoqëruara me CD ose USB, tabela në pdf dhe Excel, faqen e internetit të INSTAT-it (është krijuar një faqe e re interneti duke ndjekur praktikën më të mira të IKS-ve evropiane), Facebook, Youtube, si dhe nëpërmjet shpërndarjes së drejtpërdrejtë (të kërkesave të veçanta) të përdoruesit. Në bibliotekën e INSTAT-it përdoruesve u bëhet e mundur të kenë në dispozicion botime të shtypura. Faqja e internetit e INSTAT-it është kanali qendror i shpërndarjes së të dhënave me më shumë se gjysmën e përdoruesve të statistikave që e përdorin atë. Është një faqe e re interneti, e cila është më miqësore me përdoruesit, me funksione të reja dhe me përmirësime në lundrimin në të dhëna, motorin e kërkimit, kohën e përgjigjes, transparencën dhe disponueshmërinë.

2.1.7 Ndërgjegjësimi dhe mbrojtja statistikore

INSTAT po kryen një sërë përpjekjesh për mbrojtjen e produkteve të tij dhe vëren se ka një rritje të ndërgjegjësimin dhe të kërkesën për statistika.

¹⁰ Peer Review 2018, fq.28

Përdoruesit po shfaqin një ndërgjegjësim në rritje rreth statistikave nëpërmjet kërkesave në rritje për informacion statistikor nga INSTAT. Databaza e Kërkesave të Përdoruesve tregon se kërkesat e paraqitura nga përdoruesit kanë pësuar një rritje domethënëse, nga 729 në 2015-ën, në 1009 në 2018-ën. Informacioni rreth referimeve të INSTAT-it dhe statistikave në media (shih më sipër në pikën 2.1.6 me Përdoruesit/procesi këshillues) reflekton gjithashtu një nivel interesi dhe ndërgjegjësimi në rritje rreth statistikave.

INSTAT ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin, përfshirë edhe zhvillimin e kurseve të trajnimit, për t'u shpjeguar përdoruesve si të interpretojnë statistikën. Zakonisht, këto kurse kryhen me gazetarë të medias elektronike dhe asaj të shkruar. Gjatë vitit 2018, INSTAT miratoi një Strategji të Njohurive Statistikore. INSTAT po planifikon të përgatisë materiale për të promovuar njohuritë statistikore, që mendohet të paraqiten në shkollat e mesme, të organizojë fushata informimi për aktivitete statistikore, si fushata publicitare për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020, si dhe po prezanton artikuj shkencorë në revistën "Kërkime".

2.2 Çështje të prodhimit statistikor

2.2.1 Burimi i të dhënave

Statisticienët në SKS zotërojnë pavarësi profesionale në përzgjedhjen e burimit të të dhënave, në përputhje me nenin 4 a) të Ligjit për Statistikat 2018 dhe marrin në konsideratë cilësinë, koherencën, efikasitetin në kosto dhe reduktimin e ngarkesës së të intervistuarve në përputhje me Nenin 30, paragrafi 2.

2.2.1.1 Censet dhe anketat

SKS ndjek një program censesh dhe anketash që është në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare

Prodhimi statistikor në INSTAT bazohet në pjesën më të madhe në anketa. Si në anketat pranë biznesit, ashtu dhe ato pranë familjeve, shkallët e përgjigjes së të intervistuarve janë mjaft të larta. BSH përdor një anketë vjetore në terren për prodhimin e statistikave të Investimeve të Huaja si dhe kryen anketa të tjera.

2.2.1.2 Rekordet administrative

SKS përdor shumë rekorde administrative si të dhëna bazë për statistikën dhe po punon për të rritur përdorimin e tyre në përputhje me praktikën më të mirë aktuale evropiane.

INSTAT ka një strategji në zbatim për të siguruar përdorimin e të dhënave administrative dhe regjistrave për qëllime statistikore sa më shumë të jetë e mundur, si zëvendësuese e të dhënave nga anketat. Kjo Strategji mbështetet nga Ligji për Statistikat 2018, i cili i ofron INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore, për qëllime statistikore aksesin e duhur në të dhënat administrative që disponojnë institucionet publike.

Janë nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi nga INSTAT me shumë ofrues të dhënash (26 në fund të vitit 2018), të cilët kanë rritur numrin e burimeve të të dhënave administrative. Mbeten disa shqetësime rreth cilësisë së disa të dhënave administrative. INSTAT po bën të mundur një pikë të vetme aksesin në INSTAT për të dhënat administrative, duke mundësuar një përpunim më të frytshëm të të dhënave administrative që merr. Pavarësisht dispozitave të Ligjit të vitit 2018 për Statistikat lidhur me mandatin për mbledhjen e të dhënave për INSTAT, në praktikë ka nevojë të madhe për një bashkëpunim të vazhdueshëm mes INSTAT-it dhe mbajtësve të të dhënave administrative, në mënyrë që të sigurohet qarkullimi i të dhënave. Sipas nenit 33 të Ligjit për Statistikat 2018, BSH, si agjenci statistikore, mund të ketë të drejtën e hyrjes dhe mund të përdorë të dhënat

administrative të prodhuara nga "gjithë institucionet qendrore dhe vendore" për prodhimin e statistikave të saj. Deri tani, BSH përdor të dhënat administrative të disponueshme për aq sa është e mundur (përdoren dy lloje rekordesh administrative (RA). BSH ka një numër memorandumesh mirëkuptimi në fuqi me zotëruesit e të dhënave administrative për shpërndarje dhe shkëmbim të dhënash. Ministria e Financave dhe Ekonomisë përdor tërësisht rekordet administrative si bazë për statistikave të saj.

2.2.1.3 Burime të tjera të dhënash

Aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë për të përdorur burime të tjera të dhënash, siç janë Big Data. INSTAT po punon për rritjen e përdorimit dhe shpërndarjes së informacionit gjeo-hapësinor dhe po integron informacionin gjeo-hapësinor me informacionin statistikor, për të përmirësuar cilësinë e statistikave zyrtare, si për shembull në Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020.

2.2.2 Grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe analizimi

SKS përdor praktika të mira të pranuar ndërkombëtarisht për grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave.

Institucionet e SKS-së po bëjnë përpjekje të konsiderueshme për të bërë bashkë sistemet e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave të unifikuara dhe standardizuara. Grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i të dhënave janë të zhvilluara mirë, duke përdorur procedura statistikore solide që përfshijnë analiza pyetësorësh, përzgjedhje shkencore kampionësh, në disa raste edhe grumbullim elektronik (online) të dhënash (gjë që ka shkurtuar në mënyrë domethënëse kohën e grumbullimit dhe procesimit dhe ka përmirësuar cilësinë dhe dorëzimin në kohë të produktit statistikor), hedhje e të të dhënave, editim dhe validim (vlefshmëri) të të dhënave, si dhe imputim të tyre. Metodologjia e përdorur është hartuar, zbatuar dhe përditësuar rregullisht, në përputhje me rekomandimet metodologjike të organizatave ndërkombëtare.

Në vitin 2018, INSTAT filloi të dokumentonte proceset statistikore të secilit departament statistikor, bashkë me linjat e Modelit të Përgjithshëm të Proceseve të Prodhimit Statistikor¹¹ (GSBPM). Ai përcakton proceset që duhet të ndiqen për prodhimin e statistikave zyrtare, duke garantuar harmonizimin e terminologjisë dhe përcaktimin e një kuadri standard për planifikim dhe monitorim.

INSTAT përdor pyetësorë të printuar për anketa pranë biznesit apo familjeve dhe hedhjen e të dhënave elektronikisht. Gjithsesi, INSTAT po punon edhe për të përmirësuar grumbullimin e informacionit statistikor, duke përdorur metoda moderne siç është CAPI (Intervistës Personale me kompjuter) dhe CATI (Intervistës Personale me Telefon), të cilat përmirësojnë cilësinë, pakësojnë kohën e kërkuar, përmirësojnë përpunimin e të dhënave dhe reduktojnë vonesën në publikimin e rezultateve. Është hedhur si projekt pilot edhe CAWI (Intervista Personale Virtuale). Gradualisht, anketat do të integrohen në Depon e të Dhënave (Data Warehouse), ku softueri do të standardizohet.

Në BSH, Departamenti i Auditit është i ngarkuar të vlerësojë aplikimin e çdo metodologjie dhe manuali pune që zbatohet për një funksion të veçantë, si për shembull: grumbullim të dhënash, përpunim të dhënash, vlefshmëri të dhënash, shpërndarje të dhënash dhe menaxhim të të drejtave të në të dhëna të përdoruesve të brendshëm. Të dhënat e ndërmjetme dhe rezultatet statistikore vlerësohen rregullisht për vlefshmërinë e tyre përkundër informacioneve të tjera, aty ku është e mundur. BSH sugjeron se është e nevojshme mbështetje shtesë TIK-u për të përmirësuar saktësinë dhe dorëzimin në kohë të produkteve statistikore. BSH parashikohen risi të mëdha (të

¹¹ Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara

përfshira tashmë në plan-buxhetin afatmesëm të BSH-së), në proceset statistikore dhe në teknologjinë e informacionit, në të gjithë hapat e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave, përfshirë edhe krijimin e një *data warehouse*.

Në MFE, grumbullimi, hedhja dhe kodimi i të dhënave zakonisht monitorohet dhe rishikohet në mënyrë rutinë sipas kërkesave. Janë në zbatim manualë të cilët janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2.2.3 Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

Standardet, konceptet, përkufizimet dhe klasifikimet e zbatuara nga SKS janë përherë e më në përputhje me standardet e BE-së.

Në të gjithë fushat statistikore, INSTAT synon të ndjekë rregulloret, udhëzimet metodologjike, manualët, klasifikimet, etj., të BE-së dhe ato ndërkombëtare. Janë bërë disa modifikime për të qenë në përputhje me kushtet kombëtare dhe kërkesat e përdoruesve. Klasifikimet statistikore publikohen në faqen e internetit të INSTAT-it. Është ngritur një Komision Kombëtar për Nomenklaturën; përgjegjësia e tij është të zbatojë, përditësojë dhe t'i propozojë për miratim final qeverisë shqiptare klasifikimet statistikore në përputhje me klasifikimet statistikore evropiane.

Në BSH, metodologjia e përdorur për të përpiluar statistika zyrtare është gjerësisht në një linjë me standardet evropiane dhe standarde të tjera ndërkombëtare dhe devijimet nga standardet janë specifikuar në manualët metodologjikë. BSH zbaton rekomandime nga misionet të ndryshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Eurostat-it, për shembull Treguesit e Shëndetit Financiar (FSI) dhe Statistikat Monetare dhe Financiare (MFS) përfituan nga rekomandimet e një misioni për ndihmë teknike nga Departamenti Evropian i FMN-së.

Në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Financiare të Qeverisë (GFS) zbatojnë gjerësisht Manualin e Statistikave Financiare Qeveritare të FMN-së (GFSM) 2001; Ministria e Financave dhe Ekonomisë aktualisht po punon për të kaluar në GFSM 2014 (në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale 2010 (ESA 2010)). Prodhimi i të dhënave të borxhit përpiqet të përputhet me standardet ndërkombëtare të vendosura në Statistikat e Borxhit në Sektorin Publik, të FMN-së - Udhëzim për Përpiluesit dhe Përdoruesit 2013. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka në plan zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit e Sektorit Publik¹².

2.2.4 Çështje të cilësisë

SKS i jep shumë përparësi cilësisë statistikore dhe punon brenda një kuadri cilësie që ndjek praktikën ndërkombëtare; nxirren raporte cilësie; interesimi për cilësinë dhe praktikën e cilësisë mbështetet nga kode praktikash të formalizuara dhe deklarata angazhimi.

Në lidhje me cilësinë e statistikave, INSTAT punon sipas:

- Ligjit për Statistikat 2018;
- Angazhimit për Besimin në Statistikat e Qeverisë së Shqipërisë, 2017;
- Angazhimit për Deklaratën e Cilësisë; dhe
- Deklaratës së Politikës së Cilësisë të INSTAT-it.

¹² Një grup standardesh kontabiliteti për përdorimin në entet e sektorit publik në të gjithë botën në përgatitjen e deklaratave financiare. Këto standarde bazohen në Standardet Raportuese Financiare Ndërkombëtare, të lëshuara nga Bordi i Standardeve të Kontabilitetit.

Puna e INSTAT-it për cilësinë zbaton parimet e Menaxhimit Tërësor të Cilësisë (TQM), që ofron një kuadër të zakonshëm cilësie për Sistemi Statistikor Evropian (ESS). Për të zbatuar këto angazhime mbi cilësinë, INSTAT ka ngritur një model menaxhimi në përputhje me parimet TQM dhe ka përgatitur një Strategji Menaxhimi Total të Cilësisë¹³. INSTAT gjithashtu ka përgatitur edhe udhëzime për vlerësimin e cilësisë¹⁴.

Aktualisht, puna është përqëndruar në sigurimin e cilësisë statistikore. Kjo kërkon hartimin dhe botimin e raporteve të cilësisë me orientim-nga-përdoruesi-dhe-prodhuesi dhe vënien e tyre në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it (në vitin 2018 janë prodhuar 20 raporte dhe janë vënë në dispozicion). INSTAT ka ndërmarrë shumë nisma, si: dokumentimin e proceseve statistikore sipas sistemit GSBPM (në vitin 2018, INSTAT regjistroi 48 aktivitete statistikore, po sipas sistemit GSBPM) dhe punë përgatitore për zbatimin e Auditit Statistikor, për të garantuar cilësinë e statistikave zyrtare të prodhuara.

Në institucion organizohen kurse kualifikimi specifike në lidhje me menaxhimin e cilësisë; është marrë pjesë në kurset për cilësinë të Programit të Trajnimeve Statistikore Evropiane (ESTP).

BSH i kushton një rëndësi shumë të madhe cilësisë së statistikave që prodhon. Për këtë ajo merr në Prandaj dhe ajo merr në konsideratë standarde cilësie të pranura ndërkombëtarisht, të tilla si ato të formuluar në Standardet Speciale të Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së dhe Kuadrit të Vlerësimit të Cilësisë së të Dhënave, të cilat, nga ana tjetër, i kanë rrënjët në Parimet Themelore për Statistikat Zyrtare të Kombeve të Bashkuara.

Përkushtimi ndaj cilësisë së statistikave shprehet qartazi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për Kodin e Praktikës së Statistikave në Bankën e Shqipërisë, Nr.19, datë 29.3.2017. Për herë të parë në vitin 2017, BSH publikoi "Politika e Rishikimeve dhe Kalendarin e Statistikave të Bankës së Shqipërisë". Rishikimi është një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në fushën e statistikave, si dhe një kërkesë/komponent bazë i standardit të cilësisë së të dhënave¹⁵.

2.2.5 Metadata

Gjithë statistikat e publikuara në faqet e internetit të institucioneve prodhuese statistikore dhe raportet e cilësisë për produktet statistikore shoqërohen me metadata, të cilat, në të shumtën e rasteve, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

INSTAT përgatit dy lloj metadatash¹⁶, Metadata Strukturore dhe Metadata Referenciale, në përputhje me standardet evropiane.

Raportet e cilësisë, të orientuar nga përdoruesit dhe që përfshijnë metadat, janë publikisht të disponueshme në faqen e internetit të INSTAT-it. Gjithashtu, edhe shënime përgjithësuese metodologjike mbi metodat dhe procedurat e përdorura janë të disponueshme në kopje të printuara dhe në faqen e internetit. Politikat për Shpërndarjen e Metadatave janë përcaktuar dhe janë të publikuara në Politikat për Shpërndarjen e të Dhënave dhe Udhëzuesi.

¹³ Zbatimi i Strategjisë së Menaxhimit Total të Cilësisë, Nëntor 2017

¹⁴ Udhëzimet e Cilësisë për Proceset Statistikore nga GSBPM, fazat 1 – 8, Qershor 2018

¹⁵ Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 2017

¹⁶ Metadat strukturore përdoren për të përkufizuar strukturat e të dhënave. Emërtimet e variablave, klasifikimet, listat e kodeve standarde, llojet e variablave, përkufizimet e seteve të të dhënave janë pjesë e metadatave strukturore (harmonizimi i koncepteve, klasifikimet dhe variablat, nxitja e krahasueshmërisë së informacionit). Metadat referenciale përshkruajnë përmbajtjen dhe cilësinë e të dhënave statistikore, grumbullimin e të dhënave dhe metodat e përpunimit.

Personelit i është ofruar trajnim afatgjatë për metadat nga Eurostat. Gjithashtu, personeli merr pjesë edhe në grupe pune për metadat të organizuara nga Eurostat, si dhe në Grupin Drejtues për Metadat Statistikore. Për personelin e INSTAT-it bëhen kurse trajnimi të veçanta për zbatimin e Metadatave Referenciale dhe Metadatave Strukturore (në kontekstin e menaxhimit të cilësisë). Gjithashtu, organizohet edhe një kurs trajnimi i shkurtër për përfaqësuesit e agjencive statistikore, si BSH, për mënyrën se si të zbatohen Metadat Referenciale në produktet e tyre statistikore.

Në BSH, metadat për produkte të veçanta statistikore shkruhen në përputhje me Sistemin e Përmirësuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (e-GDDS) dhe standardet e FMN-së. BSH shpërndan (nëpërmjet publikimeve dhe faqes së vet të internetit) bashkë me statistikën metadata të hollësishme për të ndihmuar përdoruesit të kuptojnë të dhënat e shpërndara. Gjithashtu, për secilin indikator, metadat publikohen në faqen e e-GDDS ku tregohet një link i drejtpërdrejtë në faqen e statistikave të BSH, në Faqen Përmbledhëse të të Dhënave Kombëtare, në faqen e internetit të INSTAT-it dhe në faqen e internetit të FMN-së për e-GDDS. Në faqen e internetit të BSH janë publikuar një dokument gjithëpërfshirës për burimet dhe metodat për përpilimin e statistikave monetare dhe Statistikat e Sektorit të Jashtëm. Metadat janë në dispozicion vetëm në anglisht.

Metadat janë publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Buletini Statistikor shoqërohet me shënime teknike. Metadat nuk janë shkruar në përputhje me ndonjë sistem të caktuar të standardizuar metadash.

2.3 Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

2.3.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor nën të cilin funksionon SKS është bashkëkohor, me spektër të gjerë dhe shumë mbështetës ndaj punës statistikore.

Veprimtaria e INSTAT-it dhe SKS-së drejtohet në përputhje me Ligjin për Statistikat 2018, aktet nënligjore për zbatimin e tij, Vendimet e Këshillit të Ministrave, vendimet e Ansamblesë, ligjet që rregullojnë administratën publike në Shqipëri, memorandumet e mirëkuptimit, PKSZ 2017-2021 dhe nga Plani Vjetor për zbatimin e tij, si dhe nga aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve që prodhojnë statistika zyrtare, si Ligji për Censin e Popullsisë dhe Banesave (i ndryshuar). Përveç kësaj, në nivel evropian, SKS funksionon sipas rregulloreve evropiane dhe të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA).

BSH, si agjenci statistikore, ka të drejtë ligjore për të grumbulluar informacion për statistikën në përgjithësi nga Ligji për Statistikat 2018, Neni 2, ku përcaktohen “Prodhuesit e statistikave zyrtare” si INSTAT-i, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet e tjera publike, të autorizuar të prodhojnë dhe të publikojnë statistika zyrtare, sipas programit të statistikave zyrtare; dhe Neni 26, ku thuhet se “Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për produktin e statistikave zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe ligje të veçanta në zbatim të të cilave ushtron veprimtarinë Banka e Shqipërisë”. E drejta e BSH për të grumbulluar informacion për prodhimin e statistikave të Bilancit të Pagesave specifikohet në Ligjin për Bankën e Shqipërisë, Neni 27. BSH gjithashtu mbështetet në nene të tjerë të Ligjit për Bankën e Shqipërisë, ligje të tjerë që lidhen me bankat, Vendimet 2016-19 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për Kodin e Praktikës në Bankën e Shqipërisë, PKSZ 2017-2021 dhe memorandumet mirëkuptimi.

Ligji për Buxhetin Organik (Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit në Republikën e Shqipërisë") dhe Udhëzime për Performancën e Buxhetit të Shtetit, qartësisht i jep përgjegjësinë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përpilojë dhe shpërndajë Statistikat Financiare të Qeverisë.

Ligji për Statistikat 2018

Ligji për Statistikat është gjithëpërfshirës dhe në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm (ECE) për Statistikat Zyrtare për Evropën Lindore, Kaukazin dhe Azinë Qendrore¹⁷; ai është vlerësuar pozitivisht dhe konsiderohet si një hap domethënës drejt përafrimit me standardet evropiane¹⁸; është në një linjë me Kodin e Praktikës Evropiane(CoP)¹⁹.

Ligji i ri për Statistikat 2018 është një përmirësim domethënës ndaj versionit të mëparshëm dhe ofron një bazë ligjore të fortë dhe gjithëpërfshirëse për INSTAT-in dhe SKS-në. Ligji për Statistikat 2018 i) përfshin parimet e statistikave zyrtare në një linjë me Rregulloren (EU) 223/2009 dhe CoP(Kodin e Praktikës Evropiane), ii) përcakton dhe forcon funksionimin e INSTAT-it dhe SKS-së; iii) forcon rolin e INSTAT-it si koordinator i tij, iv) ofron një kuadër ligjor për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, v) rregullon procesin e planifikimit, ndjekjes dhe raportimit të veprimtarisë së statistikave zyrtare, vi) specifikon procedurat për të garantuar pavarësinë profesionale të personelit të angazhuar në proceset statistikore dhe çështjet e tjera për konfidencialitetin, qasjen në të dhëna, shpërndarjen dhe shërbimet statistikore për palët e treta, dhe vii) ndryshon rolin dhe përbërjen e Këshillit të Statistikave, duke e bërë më përfaqësuar të përdoruesve se sa Këshillin e mëparshëm. Ligji përcakton se Drejtori i Përgjithshëm (DP) i INSTAT-it emërohet nga Parlamenti "pas një procedure të hapur dhe publike përzgjedhëse", për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Pavarësia profesionale e DP garantohet nga ky ligj (Neni 16).

Avantazhet që ka sjellë ky Ligj janë se ai: i) forcon pavarësinë profesionale të INSTAT-it, ii) forcon rolin udhëheqës të INSTAT-it në prodhimin e statistikave zyrtare, iii) forcon të drejtën ligjore të INSTAT-it dhe prodhuesve të tjerë të statistikave për grumbullimin e të dhënave nga burimet në dispozicion, përfshirë dhe të drejtën e aksesit në regjistra dhe dosje administrative dhe përdorimin e tyre për prodhimin e statistikave, dhe iv) zgjeron autonominë e INSTAT-it për administrimin dhe përdorimin e burimeve të veta. Ky Ligj ka përparësi mbi çfarëdo dispozite tjetër që mund të jetë pengesë për transmetimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore ose për të garantuar konfidencialitetin statistikor²⁰.

2.3.2 Kuadri institucional dhe qeverisja

Kuadri institucional dhe marrëveshjet qeveritare janë shumë mbështetëse ndaj punës statistikore të SKS-së; zotërimi i statusit të një institucioni publik të pavarur mbështet pavarësinë e INSTAT-it dhe rrjedhimisht edhe cilësinë e statistikave.

Bazuar në Ligjin për Statistikat 2018, INSTAT ka ndryshuar statusin nga një institucion qendror nën varësinë e pushtetit ekzekutiv, në një institucion të pavarur publik, që i raporton drejtpërdrejt Parlamentit. Rrjedhimisht, DP tani ka të njëjtin status si krerët e institucioneve publike të pavarura të tjera, gjë që ndihmon në efektivitet të përmirësuar të marrëdhënieve me institucione të tjera në qeveri.

¹⁷ ECE Ligji i Përgjithshëm për Statistikat Zyrtare (Generic Law on Official Statistic,) 2016
http://www.unec.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2016/ECESTAT20163_E.pdf

¹⁸ Plani Vjetor i INSTAT-it 2019, faqe 13

¹⁹ Progres-Raporti i BE-së për Integrimin Evropian të Shqipërisë, maj 2019, fq.77

²⁰ Progres-Raporti i BE-së për Integrimin Evropian të Shqipërisë, maj 2019, fq.77

Drejtimi i INSTAT-it bëhet nëpërmjet a) DP-së; dhe b) Organit Drejtues (praktikisht emërtohet Bordi i Drejtorëve). Në Nenin 16, "Drejtori i Përgjithshëm", DP është organi më i lartë drejtues i INSTAT-it dhe në nenin 17 jepet edhe një përgjegjësi dhe autoritet i gjerë. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga gjithë personeli i nivelit të lartë të INSTAT-it (nëpunës civilë, që janë të paktën në nivelin e mesëm menaxherial), siç cilësohet në strukturën organizative të miratuar me vendim të Parlamentit.

Këshilli i Statistikave

Ekzistenca e Këshillit të Statistikave është një metodë e gjithëpranuar që garanton hyrjen e kërkesave të përdoruesve dhe palët të tjera të interesuara në planet dhe operacionet e SKS-së.

Ligji për Statistikat 2018 rishikoi anëtarësinë dhe përgjegjësitë e Këshillit të Statistikave. Themelimi i Këshillit në formën e re përfaqëson zbatimin e pikës 5 të Nenit 5/A e Rregullores (KE) 223/2009, që parashikon krijimin e një bordi këshillimor në nivel kombëtar, që jep opinion për programet statistikore dhe ndikon në sigurimin e pavarësisë profesionale të prodhuesve statistikorë. Ndryshimi i anëtarësisë së Këshillit, si dhe përgjegjësitë e tij, u japin përdoruesve një hyrje të drejtpërdrejtë në procesin për statistikat zyrtare.

2.3.3 Strukturat organizative

Strukturat organizative të krijuara për statistikat në institucionet e SKS-së janë gjerësisht të qarta, moderne dhe të krahasueshme me vendet e tjera evropiane.

INSTAT - Struktura organizative

Në vijim të Nenit 15, "Statusi dhe financimi i INSTAT-it", INSTAT është një person juridik publik i pavarur dhe organizohet në nivel qendror. Brenda strukturës organizative të INSTAT-it dhe në varësi të tij operojnë zyrat rajonale statistikore të nivelit vendor. Struktura aktuale organizative është miratuar me vendim të Parlamentit nr. 127/2018, datë 29.12.2018. Strukturë pasqyrohet edhe në në faqen e internetit të INSTAT-it. Kjo strukturë organizative ndjek strukturën e qendrueshme për një institut kombëtar të statistikave: numër i kufizuar (i menaxhueshëm) i raportimeve të drejtpërdrejta te DP dhe çdo Drejtori e Përgjithshme, me një funksion shërbimi raporton te DP dhe një shërbim të centralizuar të grumbullimit të të dhënave. Çdo njësi organizative ka një përshkrim të qartë të përgjegjësi të veta.

BSH - Struktura organizative

Në BSH ka një Departament të Statistikave (DS) që është një njësi organizative e centralizuar në strukturën e BSH. Gjithë burimet njerëzore, financiare dhe kompjuterike në Departamentin e Statistikave i kushtohen grumbullimit, vlefshmërisë, përpilimit dhe shpërndarjes së statistikave. Departamenti i Statistikave përbëhet nga tre sektorë: Sektori i Statistikave Monetare dhe Financiare, Statistikat e Sektorit të Jashtëm dhe Sektori i Procesimit dhe Publikimit të të Dhënave.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë - Struktura organizative

Në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë puna statistikore bëhet në tre njësi organizative: Sektori i Raportimeve Financiare dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, që varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit; Sektori i Statistikave & Publikimeve në Departamentin e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave, që varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike & Çështjeve Fiskale; dhe Sektori i Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit i Drejtorisë së Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit, që varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik.

2.3.4 Praktikë menaxhuese

Në institucionet e SKS-së zbatohet një shkallë e gjerë mirëmenaxhimi.

Objektivat: SKS operon sipas objektivave strategjike të përcaktuar në PKSZ 2017-2021.

Misioni, vizioni dhe kuadri strategjik: INSTAT punon brenda një misioni, vizioni dhe kuadri strategjik të mirë-zhvilluar.

Sistemi i Menaxhimit dhe Raportimit

Një Grup i Menaxhimit Strategjik ka ndërmarrë një raportim e planifikim rëndësishëm dhe të hollësishëm afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Planifikimi

PKSZ 2017-2021 është dokumenti themelor që përcakton strategjinë për zhvillimin e statistikave zyrtare dhe SKS-së për një periudhë pesëvjeçare (Ligji për Statistikat 2018, Neni 7). Ai gjithashtu përmban veprimtaritë statistikore që shërbejnë për të zbatuar strategjinë (Ligji për Statistikat 2018, Neni 8). Përmbajtja e PKSZ përcaktohet nga Ligji për Statistikat 2018, Neni 8.

Sipas Ligjit për Statistikat 2018, Neni 10.2, ka dispozita për përditësim vjetor të PKSZ-së). INSTAT përgatit një Plan Vjetor Zbatimi për PKSZ 2017-2021; fillimisht, ai është prodhuar gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 për vitin 2019 dhe është miratuar nga Parlamenti. PKSZ 2017-2021 do të rishikohet shpejt dhe do të ndjekë kërkesat e Ligjit për Statistikat 2018.

Strategjia e Zhvillimit 2017-2030 të INSTAT-it (SZH 2017-2030) specifikon objektiva strategjike për INSTAT-in për vitet 2017-2030 (afatgjatë) dhe nënobjektiva 2017-2020 (afatshkurtër). Këto janë bazuar dhe orientuar drejt përfundimit të objektivave strategjike të SKS-së, të përcaktuara në PKSZ 2017-2021. SZH 2017-2030 shoqërohet me një Plan Veprimi për Zbatimin.

Monitorimi

Është duke u kryer monitorimi i progresit. INSTAT-i ka ngritur njësi të veçanta brenda strukturës organizative për të monitoruar zbatimin e PKSZ 2017-2021 dhe Planin Vjetor të INSTAT-it (Sektori i Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit), cilësinë e statistikave në INSTAT dhe SKS (Sektori i Cilësisë dhe Metadatës), dhe koordinimin e SKS-së (Drejtoria e Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore).

Raportimi

Për të raportuar progresin kundrejt planeve, wshtë duke u zbatuar një sistem gjithëpërfshirës raportimi. INSTAT-i përgatit një raport vjetor për zbatimin e PKSZ 2017-2021 (më parë mbulonte vetëm punën e INSTAT-it), përfshirë edhe informacione nga agjenci statistikore të tjera për progresin e aktiviteteve, për të cilat janë përgjegjëse në kuadër të PKSZ 2017-2021. INSTAT gjithashtu raporton edhe për zbatimin e Planit të vet Vjetor. Plani Vjetor diskutohet në Parlament. Raporti publikohet në faqen e internetit të INSTAT-it.

Përveç kësaj, DP i paraqet Këshillit të Statistikave progres-raporte një herë në 4 muaj për zbatimin e PKSZ 2017-2021. Raporti nuk publikohet. INSTAT gjithashtu ka prezantuar një sistem raportimi tremujor për performancën e vet kundrejt Planit Vjetor të INSTAT-it. INSTAT dhe agjenci të tjera statistikore përgatitin raporte periodike për progresin e bërë për zhvillimin e statistikave në kuadër të zbatimit të MSA-së sipas planit kombëtar.

Praktika të tjera të mira menaxhimi

Praktika të tjera të mira menaxhimi lidhen me:

- a. brenda INSTAT-it ka një Grup Menaxhimi Strategjik, të përbërë nga Sekretari i Përgjithshëm, tre drejtorët e Drejtorive të Përgjithshme dhe i kryesuar nga DP. Përgjegjësia kryesore e grupit është të planifikojë, monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e burimeve të institucioneve. në mënyrë që të arrijë objektivat strategjike, si dhe të vlerësojë e menaxhojë gjithë risqet e mundshme;
- b. sisteme monitorimi, në mënyrë që të vlerësojnë efikasitetin e kostove²¹. Kjo mundëson përllogaritjen edhe të produkteve (siç janë anketat), dhe të proceseve, bazuar në GSBPM;
- c. Njësia e Auditit të Brendshëm monitoron menaxhimin dhe zbatimin e procedurave duke respektuar kuadrin ligjor shqiptar. Njësia i raporton drejtpërdrejt DP-së;
- d. INSTAT kryen anketa vjetore të Kënaqësisë së Personelit;
- e. burimet njerëzore vlerësohen çdo 6 muaj dhe eprori i tyre përkatës përgatitet një raport vlerësimi për performancën e punonjësve; dhe
- f. Indikatorët e Kuadrit të Vlerësimit të Performancës për vlerësimin e performancës institucionale që do të ndihmojë menaxhimin, kontrollin dhe monitorimin.

Në vitin 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit kreu dy audite në INSTAT, njëri që lidhej me zbatimin dhe pajtueshmërinë me rregullat ekonomike e financiare dhe tjetri për standardet e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Janë bërë rekomandime (tetë në total), të cilat më pas janë zbatuar nga INSTAT në vitin 2018.

BSH vepron brenda kontekstit të PKSZ 2017-2021. Në BSH, Departamenti i Statistikave funksionon sipas një grupi objektivash të prezantuara në 'Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë'. Dy herë në vit (në prill dhe tetor) kryhet vlerësimi i burimeve njerëzore lidhur me performancën e tyre dhe nevojat të trajnimit të personelit.

2.4 Çështje të sistemit

2.4.1 Qëllimi i Sistemit Kombëtar Statistikor

Mbulimi i SKS shqiptar, krahasuar me mbulimin e vendeve të tjera evropiane (dhe në mbarë botën), është jashtëzakonisht i ngushtë, duke përfshirë vetëm tre institucione statistika-prodhues- INSTAT-in, BSH-në dhe MFE-në.

Neni 11.1 i Ligjit për Statistikat 2018, thotë se: "Sistemi Kombëtar Statistikor përbëhet nga prodhuesit e statistikave zyrtare, të cilët janë: a) Instituti i Statistikave dhe zyrat statistikore rajonale në varësi të tij; b) Banka e Shqipërisë; c) autoritete të tjera publike, të përcaktuara sipas programit për prodhimin e statistikave zyrtare." Në PKSZ aktual 2017-2021, prodhuesi i vetëm në kategorinë (c) është Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Prandaj, SKS në Shqipëri aktualisht përbëhet vetëm nga tre organizata: INSTAT, BSH dhe MFE. Statistikat Zyrtare përcaktohen si statistikatat e prodhuara nga organizatat që janë renditur në PKSZ 2017-2021²².

²¹ Peer Review 2018, fq.24

²² Peer Review 2018, fq. 14

INSTAT-i prodhon statistika përmes një game të gjerë fushash statistikore. BSH dhe MFE janë përgjegjëse për statistikat që lidhen ngushtësisht me aktivitetet e tyre kryesore. Statistika të tjera (përfshirë edhe statistika evropiane) prodhohen dhe shpërndahen nga ministritë e ndryshme dhe agjencitë, por këto statistika nuk janë statistika zyrtare, sepse ato nuk janë të përfshira në PKSZ 2017-2021²³. INSTAT-i po përgatit një listë të institucioneve që mund të merren në konsideratë si prodhues potencialë të statistikave zyrtare, me mendimin për të zgjeruar mbulimin e SKS-së dhe statistikave zyrtare.

2.4.2 Koordinimi

Koordinimi është efektiv mes tre institucioneve që janë pjesëtarë të SKS-së; INSTAT-i njihet si koordinator për SKS-në; memorandumet e mirëkuptimit zbatohen mes pjesëtarëve të SKS-së dhe me prodhues të tjerë të statistikave dhe mbajtës të të dhënave administrative, por koordinimi shtesë mes tyre është i kufizuar; INSTAT nevojitet të angazhohet vazhdimisht në forcimin e bashkëpunimit me institucionet që ofrojnë të dhëna administrative.

Dispozitat për koordinimin janë shumë të forta dhe të plota, siç përshkruhen në Ligjin për Statistikat 2018. Sipas Nenit 12, “Sistemi Kombëtar Statistikor duhet të koordinohet nga INSTAT-i për të siguruar që të gjithë

prodhuesit e statistikave zyrtare përdorin standardet, konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodologjitë statistikore të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe Eurostat-i, aty ku është e mundur”. Ky koordinim përfshin “aktivitetet në vend për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare”, si dhe “programim dhe raportim statistikor, monitorim të cilësisë, metodologji, transmetimit të të dhënave dhe komunikimit mbi veprimtaritë e Sistemit Kombëtar Statistikor”. Aktualisht, mekanizmat kryesore të koordinimit janë: mbledhjet e Këshillit të Statistikave; PKSZ 2017-2021; Kalendarët Vjetorë të Publikimeve dhe Memorandumet e Mirëkuptimit.

Mënyra të tjera koordinimi

Është duke u ngritur një Komitet i Prodhuesve të të Dhënave, që përfshin INSTAT-in, BSH-në dhe MFE-në. Gjithashtu, janë ngritur grupe të ndryshme pune mes INSTAT-it dhe prodhuesve të tjerë të statistikave ose ofruesve të të dhënave²⁴, që kanë për qëllim të garantojnë zbatimin e duhur të memorandumeve të mirëkuptimit dhe të sjellin ide ose veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. INSTAT, BSH dhe MFE kanë ngritur dy grupe pune të tillë²⁵.

2.4.3 Besueshmëria të statistikave

SKS ka disa marrëveshje institucionale në veprim për të nxitur besimin te institucioni dhe produktet e tyre; SKS ka personel shumë të aftë për cilin përdoruesi gëzon respekt dhe besim.

Angazhimi për Besimin në Statistikat e Qeverisë së Shqipërisë, 2017, referuar pikës B. 4 më sipër, Çështje të cilësisë, garanton pavarësinë e statistikave zyrtare dhe institucioneve mbështetëse, si dhe kontribuon për të ruajtur besimin e publikut në statistikat zyrtare të prodhuara në Shqipëri.

Marrëveshjet në vijim mbështesin besimin në funksionimin e INSTAT-it:

²³ Peer Review 2018, fq.11,12

²⁴ Peer Review 2018, fq.12

²⁵ Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, 2017

- a. INSTAT ka përshtatur një Kod Etike për zbatimin e standardeve të etikës institucionale (Vendimi nr. 390 prot., datë 03.13.2017);
- b. Rregullat e Procedurave gjithashtu përmbajnë një kapitull të veçantë për standardet e sjelljes në institucion dhe mënyrat e veprimit në rast shkeljeje të saj²⁶; dhe
- c. Ka gjithashtu një kërkesë të qeverisë që titullarët duhet të veprojnë në përputhje me parimet e etikës së shëndoshë, të diktuar nga Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

Besimi mbështetet gjithashtu nga proceset e planifikimit dhe raportimit të INSTAT-it. PSKZ 2017-2021 dhe Plani Vjetor janë miratuar nga Parlamenti dhe është bërë publik në faqen e internetit të INSTAT-it. Gjithashtu, në Parlament është paraqitur edhe Raporti Vjetor i INSTAT-it, që është publikuar në të njëjtën mënyrë. PKSZ 2017-2021, planet dhe raportet për progresin, ofrojnë informacion të dobishëm dhe të rëndësishëm për përdoruesit dhe palë të tjera të treta, sigurojnë një shkallë të rëndësishme transparence dhe ato mbështesin besimin te institucionet.

BSH e ndërton besimin duke vënë në dispozicion të publikut termat dhe kushtet në të cilat grumbullohen, përpunohen dhe shpërndahen të dhënat. Ligjet dhe rregulloret në bazë të të cilave grumbullohen, përpunohen dhe shpërndahen të dhënat nga BSH janë gjithashtu në dispozicion të publikut.

2.4.4 Konfidencialiteti

Ruajtja e konfidencialitetit statistikor mbulohet në mënyrë specifike në Ligjin për Statistikat 2018 dhe zbatohet nga SKS.

Dispozitat ligjore për mbrojtjen e konfidencialitetit statistikor janë përcaktuar gjerësisht në Nenin 31 të Ligjit për Statistikat 2018. Gjithashtu, ka rregulla dhe procedura të brendshme për konfidencialitetin e statistikave, sigurinë e informacionit dhe të dhënat personale. Ka gjithashtu edhe një rregullore të brendshme që përmban rregullat etike për të përpunuar të dhënat personale, firmosur mes INSTAT-it dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave. Gjithë personeli i INSTAT-it firmos një deklaratë konfidencialiteti kur punësohet²⁷.

Në INSTAT nuk ka ndonjë njësi organizative të veçantë që të merret me monitorimin e konfidencialitetit statistikor. Çdo njësi prodhimi statistikor është përgjegjëse për monitorimin dhe vazhdueshmërinë e monitorimit të konfidencialitetit të të dhënave të veta. Drejtoria e IT-së është përgjegjëse për ofrimin e sigurisë së informacionit elektronik. Në INSTAT është ngritur edhe Komisioni i Konfidencialitetit.

INSTAT, bazuar në udhëzimet e Eurostat-it, ka punuar për të përshtatur një Manual të Mbrojtjes së të Dhënave Statistikore Konfidenciale, si dhe atë për të dhënat personale dhe të kompanive. Janë të pranishme edhe masat e sigurisë fizike për të mbrojtur të dhënat. INSTAT po zhvillon një Sistem të Integruar TIK, i cili do të ruajë në mënyrë të centralizuar dhe të sigurtë të dhënat që menaxhohen aktualisht në skedarë të sheshtë (flat files). Puna është në vazhdim e sipër dhe do të përbëjë një proces të vazhdueshëm.

²⁶ Vitin e kaluar u regjistrua vetëm një rast i dhunimit të etikës profesionale, gjë që bie ndesh me Kodin e Etikës së institucionit dhe normat e Rregullave të Procedurës. Bazuar në këto akte, si dhe në legjislacion, INSTAT mori masat e duhura për t'i dhënë fund marrëdhënies së punës. Ky vendim u çua në apel.

²⁷ Peer Review 2018, fq.18

Në BSH konfidencialiteti respektohet me rreptësi (dhe vëzhgohet në praktikë) sipas Nenit 58 (1) të Ligjit për Bankën e Shqipërisë. “Kodi i Praktikës për Statistikat e Bankës së Shqipërisë”, “Kodi i Etikës së Bankës së Shqipërisë” dhe “Rregullorja për Transparencën dhe Konfidencialitetin e Bankës së Shqipërisë” gjithashtu përmbajnë dispozita për konfidencialitetin. Të gjitha këto dokumente janë të publikuara në faqen e internetit të BSH. Çdo punonjës i BSH firmos një kontratë individuale me punëdhënësin. Mes detyrimeve të punonjësit, sipas kontratës së punës, është edhe respektimi i Kodit të Etikës së BSH, i cili përmban rregulla të qarta në lidhje me konfidencialitetin.

Në MFE janë të pranishme Udhëzimet për përgjegjësinë e përdoruesit në Sistemin e Informacionit Financiar të Automatizuar të Qeverisë (AGFIS). Ka udhëzime për hapat e përditshëm në përdorimin e AGFIS. Gjithashtu, ka edhe rregullore të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për dispozitat fizike dhe teknologjike për të mbrojtur sigurinë e databazave.

2.4.5 Roli i Partnerëve për Zhvillim

SKS ka marrë mbështetje dhe bashkëpunim domethënës nga Eurostat-i, organizatat ndërkombëtare dhe institucione të tjerë kombëtarë statistikash nga vendet anëtare; është në fuqi një mekanizëm koordinimi i cili funksionon mirë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar statistikor në Shqipëri synon të përmirësojë përputhshmërinë e statistikave me standardet e BE-së dhe Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, bashkëpunimi ofron mbështetje dhe asistencë në ndërtimin e kapaciteteve statistikore përmes rritjes profesionale të personelit statistikor.

INSTAT-it i është ofruar bashkëpunim në fushën e monitorimit të progresit të zhvillimit statistikor përmes një procesi *Peer Review*, që përfshin edhe *Peer Review*-të sektoriale, që kanë ofruar rekomandime të herëpashershme dhe mbështetje për aktivitete të veçanta statistikore nëpërmjet projekteve në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA). Një pjesë e madhe e ndihmës është ofruar nga BE, Zyra Federale e Statistikave të Zvicrës, Agjencia Suedeze e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar (Sida), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore. Çdo vit, mbahen mbledhje koordinimi mes INSTAT-it dhe Partnerëve për Zhvillim dhe ka kontakt të ngushtë të vazhdueshëm mes INSTAT-it dhe Partnerëve për Zhvillim për secilin nga projektet në fjalë.

BSH është përfituese e vazhdueshme e asistencës teknike dhe projekteve/programeve që fokusohen në përmirësimin e aktiviteteve statistikore dhe produkteve statistikore. Departamenti i Statistikave përfton mbështetje në lidhje me rekomandimet statistikore nga misionet e ndryshme të FMN-së dhe Eurostat-it, p.sh., mbështetje nga Departamenti Evropian i FMN-së, për Indikatorët e Shëndetit Financiar (FSI) dhe Statistikat Monetare dhe Financiare (MFS).

MFE ka marrë mbështetje teknike nga një mision i FMN-së për Statistikat Financiare Qeveritare (GFS).

2.5 Burimet

2.5.1 Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

SKS ka një numër në rritje personeli për t'u përballuar integritet evropian; personeli ka fituar përvojë profesionale të konsiderueshme dhe trajnime që do t'i ndihmojnë të zhvillojnë aktivitetet e tyre statistikore

dhe në cilësinë e produktit të tyre dhe këtë dije e njohuri ata mund t'ua përçojnë personelit të ri; personeli është jashtë mase i motivuar²⁸; i vihet shumë theksi dhe planifikohet trajnimi i personelit dhe është aktive edhe Qendra e Trajnimeve Statistikore.

Personeli

Një vendim i Asamblesë në dhjetor 2018 miratoi 20 punonjës shtesë për INSTAT-in. Struktura e re organizative e INSTAT-it (miratuar në dhjetor 2018) ka në përbërjen e saj organizative një total prej 236 punonjësish (216 prej të cilëve janë të mëparshëm), 174 punonjës të zyrave qendrore, 50 punonjës nga zyrat rajonale; 224 janë pozicione me status të shërbimit civil dhe 12 punonjës jashtë statusit të shërbimit civil. Përveç kësaj, ka 310 intervistues të përhershëm dhe 1,600 intervistues të përkohshëm (shumica me kohë të pjesshme)²⁹. Ashtu si në vitet e mëparshme, personeli i INSTAT-it përbëhet në më të shumtën prej femrave (69%).

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Statistikat 2018, INSTAT-i përfitoi statusin e një institucioni të pavarur dhe pavarësi në menaxhimin e burimeve të veta njerëzore dhe financiare, përfshirë rekrutimin dhe administrimin. Personeli i INSTAT-it rekrutohet në mënyrë të hapur dhe me kualifikimet e përshtatshme nga disiplinat përkatëse. Personeli është jashtëzakonisht i arsimuar, me 90% që zotërojnë një diplomë Master dhe 3% që kanë vetëm gradën Bachelor. Çdo 6 muaj plotësohet një vlerësim për performancën e çdo punonjësi nga eprori i drejtpërdrejtë që i ka në varësi.

Raporti i "Peer Review 2018" gjeti se INSTAT nuk është në gjendje të tërheqë profesionistë të lartë, duke pasur parasysh nivelin e pagës për personelin, që është në përgjithësi më i ulët krahasuar me institucionet e tjera publike. INSTAT e gjykon si të përshtatshme madhësinë dhe cilësinë e burimeve njerëzore. Gjithsesi, Raporti i Progresit i BE-së për Integrimin Evropian të Shqipërisë (Maj 2019) arrinte në përfundimin se buxheti dhe personeli i INSTAT-it vazhdonin të ishin të pamjaftueshëm për të zbatuar plotësisht acquis-in e BE-së në fushën e statistikave.

Departamenti i Statistikave në BSH ka 34 veta në personel, që përbëhet nga një drejtor dhe 33 zyrtarë statistikash. Ka 2 pjesëtarë personeli TIK. Kryesisht personeli ka diplomën Master (97%, me një doktoraturë). Kryesisht, personeli përbëhet nga femra (rreth 80%). Gjithë personeli i ka zyrat qendrore në Tiranë. Burimet e personelit në terma numrash raportohen nga BSH si të përshtatshme për të prodhuar Statistikat Monetare dhe Financiare (MFS) dhe Statistikat e Sektorit të Jashtëm dhe gjithë grupet e statistikave për mbikëqyrjen mikro dhe makro. Dy herë në vit (prill dhe tetor) kryhet një vlerësim i burimeve njerëzore në lidhje me performancën dhe nevojat e trajnimit.

Në MFE numri i personelit që merren me statistika është raportuar nga MFE si i përshtatshëm. Të dy bashkë - arsimimi dhe trajnimi i personelit të statistikave raportohet nga MFE si i papërshtatshëm për punën statistikore.

prodhimin e vazhdueshëm statistikor, por numri i personelit sfidohet nga detyrat që duhet të realizojë për të arritur acquis në statistika dhe në procesin e

²⁸ Anketa e INSTAT-it për Kënaqësinë e Personelit

²⁹ Peer Review 2018 fq.11

Trajnimi dhe zhvillimi

Për të mbështetur zhvillimin e personelit të statistikave dhe për të garantuar që personeli të jetë me njohuri të përditësuara nevojitet trajnim i vazhdueshëm. Përveç kësaj, ndërkohë që pjesë e personelit largohet nga INSTAT-i, është thelbësor trajnimi i personelit të ri. Aktualisht, personeli merr pjesë në trajnime në ambientet e veta, në shumë programe trajnimi jashtë institucionit, kurse ndërkombëtare, seminare dhe workshope, përfshirë edhe kurset ESTP të organizuara nga Eurostat-i³⁰.

Në maj 2018, INSTAT përcaktoi një Strategji Trajnimi dhe një Kalendar vjetor të Trajnimeve, me qëllimin për të ngritur, përmirësuar dhe sjellë dijen profesionale në kushte aktuale e të përditësuara jo vetëm për personelin e INSTAT-it, por edhe për personelet e agjencive statistikore, prodhuesve të tjerë të statistikave dhe mbajtësit e të dhënave administrative, median, botën akademike, si dhe përdoruesve të ndryshëm të statistikave zyrtare.

Ngritja e Qendrës së Trajnimeve Statistikore, përmes kontributit dhe mbështetjes së Sida-s, është një mjet i vlefshëm për të përmirësuar kapacitetin profesional të personelit të INSTAT-it dhe personeleve të institucioneve të tjera. Kjo Qendër i ndërmerr veprimtaritë e veta në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën shqiptare të Administratës Publike, në përputhje me Nenin 8 të Ligjit Nr. 152/2013 "Për shërbimin civil", të ndryshuar, dhe Nenet 27 e 28 të Ligjit për Statistikat 2018.

Personeli i BSH merr pjesë rregullisht në seminare kombëtare dhe ndërkombëtare. Personeli gjithashtu merr pjesë në konferenca dhe seminare ndërkombëtare për statistikat, të organizuara nga organizata rajonale dhe ndërkombëtare, për të qenë në një hap me zhvillimet e reja në standardet statistikore dhe praktikatat më të mira që mund të aplikohen në lidhje me statistikat monetare.

Lidhur me metodologjinë dhe metodat e përpilimit ofrohet trajnim formal i brendshëm dhe trajnim në vendin e punës. Punonjësit marrin pjesë rregullisht në seminare, kurse dhe *workshope* të organizuar nga BSH, Banka Qendrore Evropiane, FMN, Eurostat-i dhe bankat e tjera kombëtare qendrore për të përmirësuar më tej dijen e tyre për praktikatat statistikore që zbatohen. Personeli i punësuar rishtazi në Departamentin e Statistikave merr trajnim të detyrueshëm për objektivat/detyrat, praktikatat e përpilimit, metodologjitë dhe produktet statistikore.

Në MFE trajnimi konsiderohet si zgjidhja e problematikave dhe kufizimeve ekzistuese; personeli ka nevojë për trajnim për menaxhimin e të dhënave statistikore, konsolidimin e të dhënave për njësitë jashtë-buxhetore të qeverisjes qendrore/lokale, dhe ESA 2010.

Kënaqësia e Punonjësve

Peer Review 2018³¹ raportoi se personeli që u takua me ekipin e *Peer Review* tregoi përfshirje dhe përkushtim të lartë. Personeli i ri tregoi motivim dhe entuziazëm, vlerësoi ambientin e hapur dhe mbështetës brenda INSTAT-it. Si pjesë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në mënyrë që të përmirësohet kënaqësia e punonjësve, INSTAT-i kryen një herë në vit Anketën e Kënaqësisë së Punonjësve; është zhvilluar edhe një plan për të përmirësuar kënaqësinë e personelit bazuar në rezultatet e këtyre anketave.

³⁰ Analiza Sektoriale e Zbatimit të Anketës së Punës në Shqipëri, Tetor, 2016, fq. 6, 8, 9

³¹ *Peer Review* 2018, fq 4 and 13

2.5.2 Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

SKS ka infrastrukturë të përshtatshme fizike dhe strukturë TIK të përditësuar; në disa institucione ka planifikime strategjike për TIK dhe janë prezantuar dhe disa die inovative.

Zhvillimi TIK

Në kuadër të modernizimit institucional dhe komunikimit të përmirësuar me grupe të ndryshme përdoruesish, INSTAT është i përkushtuar të zhvillojë sisteme inovative TIK për grumbullimin e të dhënave statistikore dhe për proceset e prodhimit statistikor. Kjo është bërë në kuadër të Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Planit Strategjik të Teknologjisë së Informacionit. Përbërësit më kryesorë të këtij zhvillimi janë mbështetja TIK për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020 dhe Strategjia e Komunikimeve, të miratuara gjatë vitit 2018. Zhvillimi i TIK është një nga qëllimet më kryesore strategjike të INSTAT-it, në mënyrë që të mbështeten njësitë e saj me mjetet e duhura për përmirësimin e cilësisë së statistikave. Zhvillimi i TIK është ndihmuar dhe nga auditi i Kontrollit të Lartë të Shtetit në 2017; rekomandimet janë plotësuar në masën 100% nga INSTAT-i, bazuar kjo në vlerësimin e Kontrollit të Lartë për zbatimin e rekomandimeve, kryer në vitin 2018.

Përveç rekomandimeve të Kontrollit të Lartë, kohët e fundit i është dhënë prioritet edhe i) sigurisë së informacionit; ii) zhvillimit të shërbimeve në internet (mënyra të sigurta të transmetimit të të dhënave administrative) për të reduktuar ngarkesën e intervistave; iii) kapacitetit statistikor në rritje; iv) mënyrave të përmirësuar të shpërndarjes dhe komunikimit; dhe v) një sistem i integruar i teknologjisë së informacionit (Depo e të Dhënave Statistikore-*Statistical data warehouse*), që do të shërbejë si sistem qendror për menaxhimin e të dhënave dhe metadatat statistikore.

Gjatë vitit 2018, INSTAT vazhdoi të zbatonte fazën e pestë të bashkëpunimit me Statistikave të Suedisë (Statistics Sweden) dhe INSTAT-it. TIK ka qenë një nga prioritetet e vazhdueshme në këtë bashkëpunim. Objektivi kryesor është modernizimi i infrastrukturës së platformës ekzistuese. Gjithashtu, INSTAT ka përfituar nga Sida financime për të mbuluar prokurimin e pajisjeve TIK.

Statusi aktual i TIK

Si rezultat i përmirësimeve të fundit, INSTAT ka një infrastrukturë të re TIK, që përfshin pajisjet e qendrës së të dhënave, servera të rinj dhe hapësirë ruajtjeje të të dhënave, si dhe pajisje rrjeti. Gjithë personeli i zyrave qendrore është i pajisur me kompjutera personalë të rinj. Personeli në zyrat rajonale do të marrë pajisje të reja nga projekti SALSTAT gjatë vitit 2019.

Proceset statistikore në INSTAT përdorin një gamë të gjerë TIK. Hedhja e të dhënave bëhet kryesisht me Visual studio dhe CPro; kontrolli i të dhënave bëhet kryesisht me servera SQL, SPSS, SAS, Excel, dhe në disa raste Access; tabelat e të dhënave bëhet duke përdorur server SQL, SPSS, SAS, Excel dhe Access. Në departamente të ndryshme, softueri i përdorur ndryshon gjerësisht. Kjo rrit ndërlikimin dhe pakëson efikasitetin. Gjithashtu, kjo çon në kosto të mëdha për licensat, mirëmbajtjen e sistemit, mbështetjen dhe trajnimin. INSTAT mendon se ka infrastrukturë të përshtatshme TIK që mbështet produktin statistikor.

Personeli i BSH ka kompjutera personalë. Të gjithë kompjuterët kanë Access dhe licensa të reja të SPSS dhe SAS. Një zhvillim i mirëpritur është edhe zbatimi i Vizor dhe Sistemit Ndërkombëtar të Raportimit të

Transaksioneve. BSH ka përmirësuar tashmë edhe aspekte të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, por nevojitet progres i mëtejshëm.

Në BSH, risitë më të mëdha janë parashikuar (të përfshira tashmë në planin buxhetor afatmesëm të BSH-së) në proceset statistikore dhe TIK në të gjithë hapat e prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave. Objektivi është të vendoset një zgjidhje e bazuar në teknologji me ndërfaqe fleksibël për të grumbulluar të dhëna, për të kontrolluar vlefshmërinë, kryer vlerësime si dhe përlogaritje, për të modifikuar të dhënat për besueshmëri në raportim sipas nevojës, dhe për shpërndarjen. BSH e vlerëson gjendjen e TIK si “shumë të mirë”.

MFE e raporton TIK si të vjetër dhe të papërshtatshme. MFE ka nevojë për kapacitete teknologjike të përmirësuara për të menaxhuar të dhënat statistikore; në veçanti, është e dëshirueshme të automatizohet futja manuale e të dhënave në AGFIS, duke zhvilluar gradualisht një ndërfaqe mes sistemeve TIK.

2.5.3 Infrastruktura statistikore

Regjistrat e biznesit dhe regjistrat me të dhëna familjare

Regjistrat e biznesit dhe regjistrat me të dhëna familjare kryesisht mbahen nga INSTAT dhe janë në dispozicion të SKS-së.

Në INSTAT, gjithë anketat e biznesit të drejtuara aktualisht nga INSTAT-i, kanë si bazë të tyre Regjistrin Statistikor të Biznesit. Të gjitha anketat e regjistrave familjarë të drejtuara nga INSTAT-i kanë si bazë të tyre Regjistrin Familjar, bazuar në Censin e Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011. Ka filluar puna për zhvillimin e një regjistri statistikor të popullsisë.

Infrastruktura të tjera statistikore

SKS ka në dispozicion një numër të konsiderueshëm infrastrukture statistikore dhe një objektiv të qartë për shtrirjen e disponueshmërisë së tyre.

Në kontekstin e Strategjisë së Zhvillimit 2017-2030, INSTAT do të zhvillojë dhe zbatojë rregullore, udhëzime, manualë dhe dokumenta të tjerë formalë, në përputhje me rregulloret e BE-së, për të ndihmuar institucionin drejt arritjes së objektivave strategjikë.

BSH e vlerëson infrastrukturën aktuale statistikore si “shumë të mirë”.

MFE ka akses në manualin e përditësuar GFS nga FMN-ja. Janë në fuqi udhëzimet dhe manualët (që përfshijnë projektimin e zgjidhjes për sistemin e informacionit financiar të automatizuar), të cilat shpjegojnë metodologjinë e proceseve statistikore. Janë në fuqi disa manualë për përpunimin: Në lidhje me borxhin, Menaxhimi i Borxhit dhe Manuali i Sistemit të Analizës Financiare si dhe ka dhe një Manual Procedurash. Manualët teknikë janë në dispozicion për përdoruesit e sistemit AGFIS.

2.5.4 Buxheti për statistikat

Anëtarët e SKS-së i kanë gjykuar buxhetet e tyre si të mjaftueshëm.

Financimet në dispozicion për INSTAT-in nga të gjitha burimet kanë treguar nivele dukshëm më të larta për vitin 2017 dhe 2018 se sa vitet e mëparshme, siç tregohet në tabelën në vijim.

Tabela 1 : Fondet në dispozicion për INSTAT-in

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Fondet në TOTAL (ooo lekë)	389,581	468,876	383,678	367,680	516,964	560,318

INSTAT-i e gjykon nivelin e burimeve financiare si të mjaftueshme. Megjithatë, Raporti i Progresit për Integrimin Evropian të Shqipërisë (maj 2019) arriti në përfundimin se buxheti dhe personeli i INSTAT-it vazhdonin të ishin të pamjaftueshëm për të zbatuar plotësisht acquis-in e BE-së në fushën e statistikave.

BSH e konsideron buxhetin si të mjaftueshëm, por kufizimet buxhetore ndonjëherë e bëjnë të pamundur për personelin të marrë pjesë në aktivitetet të parashikuara kualifikuese.

MFE raporton se buxheti është i mjaftueshëm për operacionet statistikore.

2.5.5 Financimi për statistikat

Burimet e financimit për të kryer aktivitetet financiare dhe mbështetëse kryesisht ofrohen nga buxheti i shtetit për SKS-në; ky plotësohet nga financime të huaja domethënëse përmes projekteve të asistencës teknike; INSTAT-i fiton disa të ardhura nga veprimtaritë statistikore dytësore.

2.6 Analiza SWOT

Në PKSZ 2017-2021 (9 shkurt 2017) u zhvillua një analizë SWOT; një tjetër SWOT u bë në DS 2017- 2030 (15 shtator 2017). Një SWOT më e kufizuar u përfshi gjithashtu në Raportin për Strategjinë e Shpërndarjes 2018. SWOT-i që erdhi pas i shkrin të gjithë të mësipërmët bashkë, i përditëson ato sipas nevojës, heq ato që nuk janë më të zbatueshme dhe shton përbërës të rinj të bazuar në vlerësimet aktuale.

FUQITË (STRENGTHS)

- Kuadër ligjor gjithëpërfshirës i përditësuar - Ligji Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare;
- Personel me përvojë teknike;
- Reputacion pozitiv me përdoruesit;
- Koordinator i përcaktuar për SKS-në (INSTAT);
- Lidhje e fortë me institucioneve statistikore (bazuar në Memorandumet e Mirëkuptimit);
- Personel profesional dhe jashtëzakonisht i motivuar;
- Kapacitet për të përçuar njohuritë e përfuara te kolegët dhe përdoruesit;
- Pajtuëshmëri dhe zbatim i standardeve statistikore ndërkombëtare;
- Marrëdhënie të mira me institucione të ngjashme në vendet e rajonit dhe më tej;
- Ndërgjegjësim për standardet e cilësisë së statistikave zyrtare; dhe
- Qendra për Trajnimet Statistikore është operacionale.

DOBËSITË (WEAKNESSES)

- mungesë formalizimi të komunikimit me institucioneve;
- infrastrukturë statistikore jo e plotë në institucione; dhe
- niveli i kërkesave të punës së re dhe asaj në vazhdim vë para sfidave personelin

MUNDËSITË (OPPORTUNITIES)

- mbështetje e fortë qeveritare për statistikat;
- kërkesë në rritje për statistikat;
- shfrytëzimi i dispozitave të Ligjit për Statistikat 2018;

- d. imazh i përmirësuar publik i INSTAT-it; dhe
- e. interes i vazhdueshëm dhe mbështetje e zgjeruar nga Partnerët për Zhvillim.

KËRCËNIMET (THREATS)

- a. afat kohor dhe plotësim i pamjaftueshëm i të dhënave të regjistruara;
- b. mungesë e burimeve financiare të mjaftueshme, dhe të personelit;
- c. shkallë e lartë e qarkullimit të personelit;
- d. përdorim i paktë dhe keqkuptim i të dhënave statistikore të publikuara; dhe
- e. mungesë e fakulteteve për të diplomuar statisticienë.

Kapitulli 3

Vlerësimi i institucioneve statistika-prodhues

Përveç vlerësimit të SKS- (INSTAT-it, BSH-së dhe MFE-së), është kryer edhe një vlerësim³² i institucioneve statistika-prodhuese, për disa tema kryesore të përzgjedhura si më poshtë (të cilat janë gjithashtu të mbuluara edhe në vlerësimin e SKS-së).

3.1 Plotësimi i nevojave të përdoruesve

3.1.1 Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave

Pjesa më e madhe e institucioneve (më shumë se 70%) kanë nxjerrë të paktën një publikim statistikor. Zakonisht, publikimi është një buletin ose raport vjetor, dhe ndonjëherë edhe ndonjë publikim gjashtëmujorë ose tremujorë, që përmban tema që lidhen me fushën e përgjegjësisë që mbulon institucioni. Në disa raste, , informacioni gjendet gjithashtu edhe në faqet e internetit. Mangësitë kryesore, problemet dhe boshllëqet në përmbushjen e nevojave të përdoruesve, për të cilat janë të vetëdijshëm prodhuesit, janë: cilësia, disagregimi, dorëzimi në kohë, njohuri jo të plota apo moszbatimi i koncepteve, përkufizimeve, klasifikimeve apo metodave teknike ndërkombëtare.

Prodhuesit e statistikave do të donin këto përmirësime të produkteve të tyre statistikore : krijimin dhe standardizimin e metadateve për statistikatat aktuale; rritjen e cilësisë së të dhënave, duke përfshirë periodicitetin, dorëzimin në afat dhe disagregimet; seri të reja statistikore; si dhe përmirësim të produkteve sipas përkufizimeve dhe standarteve të Eurostat-it.

3.1.2 Statistikat e disagreguara (statistikat lokale dhe disagregime të tjera)

Thuajse të gjitha institucionet e shqyrtuara i disagregojnë statistikatat e tyre. Të dhënat zakonisht disagregohen sipas gjinisë, moshës, në disa raste edhe vendndodhjes gjeografike ose ndonjë fushe interesi për institucionin. Më shumë se gjysma e institucioneve nuk ka plane për të bërë ndryshime të reja apo përmirësime të nivelit ekzistues të disagregimit.

3.1.3 Shpërndarja e të dhënave

Prodhuesit përdorin mjete të ndryshme për shpërndarjen e të dhënave, përfshirë edhe publikime të printuara, publikime dhe tabela në faqet e internetit, dhe informacion në formë të ndryshme në përgjigje të kërkesave. Vihet re që databazat në faqet e internetit nuk përdoren nga ndonjë prej prodhuesve si mjet shpërndarjeje.

³² Vlerësimi është bërë nga 23 prill-09 maj 2019. Kryesisht, u bë në bazë të pyetësorëve të printuar që iu dërguan me postë institucioneve, ku iu bashkangjiten më pas intervistat ballë për ballë, me telefon dhe me e-mail. Morën pjesë shtatëmbëdhjetë prodhues statistikash (shih 8.2 Shtojca II për më shumë hollësi). Informacioni u përfutua kryesisht prej personit përgjegjës për statistikatat ose prej një specialisti që punonte në njësinë organizative përgjegjëse për statistikatat. Në përgjithësi, të gjithë institucionet iu përgjigjën të gjitha pyetjeve në pyetësor, me përjashtim të 6 institucioneve që u përgjigjën pjesërisht (por që, megjithatë, e plotësuan më shumë se 50 % të pyetjeve). Intervistat u drejtuan nga një Këshilltar Kombëtar shqipfolës, me përvojë në statistikatat kombëtare dhe që punon me INSTAT-in.

3.2 Çështje të prodhimit të statistikave

3.2.1 Burimi i të dhënave

Pjesa më e madhe/shumica e prodhuesve të statistikave përdorin si burim të dhënash për statistikatat e tyre rekordet e tyre administrative. Vetëm rreth një e treta e institucioneve janë përfshirë në konsultime për projektimin e të dhënave administrative, në mënyrë që të dhënat të bëhen më të përshtatshme për qëllime statistikore. Më shumë se gjysma e prodhuesve kanë zyra rajonale ose të paktën specialistë që merren me statistikatat në zyra lokale. Këto zyra zakonisht grumbullojnë, përpunojnë të dhëna dhe i përcjellin ato rregullisht në zyrën qendrore. Ndonjëherë, raportet prodhohen në zyrat statistikore lokale (një herë në muaj ose një herë në tre muaj për aktivitetet që kryhen gjatë periudhës së referencës nga zyrat lokale) dhe (rrallë) regjistrat mund edhe të përditësohen në nivel lokal.

3.2.2 Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave

Pjesa më e madhe e prodhuesve vendosin standarde për proceset statistikore. Këto përfshihen në manuale, udhëzime dhe udhërrëfyes që synojnë të garantojnë standardet përgjatë proceseve. Në disa institucione referenca bëhet me standardet, manualët dhe udhëzimet e INSTAT-it. Në të tjerë, udhëzimet përkatëse gjenden në legjislacionin në fuqi dhe "urdhrat e ministrisë". Prodhuesit kanë identifikuar nevojën për projektimin dhe funksionimin e një sistemi/softueri online që do ti ndihmojë ata në përmirësimin e procesit.

Institucionet prodhuese kanë renditur si më poshtë përmirësimet operative dhe të sistemit, të cilat do të donin t'i shihnin të zbatuara: zhvillimi të databazës; udhëzimet/manualët për hartim/përpunim/ publikim për secilin indikator statistikor; një sistem statistikor të integruar që do t'u mundësonte të gjithë indikatorëve të integroheshin në sistem, duke përfshirë edhe regjistrimin e indikatorëve drejt e nga burimi i të dhënave dhe përpunimi i tyre automatikisht nga sistemi; krijimi dhe standardizimi i metadatës për statistikatat aktuale; kalimi në një sistem on-line me dorëzim të informacionit në kohë reale.

3.2.3 Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare nuk është i konsoliduar. Më pak se gjysma e institucioneve përdorin konceptet, klasifikimet dhe përkufizimet ndërkombëtare.

3.2.4 Çështje të cilësisë

Teknikat/mjetet për kontrollin e cilësisë së statistikave dhe raporteve të cilësisë nuk janë të konsoliduara. Megjithatë, prodhuesit përpiqen të garantojnë cilësinë e statistikave të tyre duke i dhënë vëmendje formatit dhe modeleve (templates) për grumbullimin e të dhënave, zbatimin e udhëzimeve se si të prodhohen dhe të përlogariten të dhënat, si dhe kryerja e kontrolleve të bashkërenduara në të dhënat e përpunuara. Pak prej institucioneve prodhojnë raporte për cilësinë e statistikave në institucionet e tyre.

3.2.5 Metadata

Deri në njëfarë mase, prodhuesit në përgjithësi kanë aktualisht, një përshkrim të të dhënave që prodhojnë. Asnjë prodhues pohon se përdor një sistem të përcaktuar metadatash të standardizuar.

3.3 Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

3.3.1 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë statistikore të institucioneve statistika-prodhues mbështetet në Ligjin për Statistikat 2018 dhe ligjet përkatëse që mund të jenë të zbatueshme për secilin institucion. Anketa e SALSTAT-it ka treguar se institucionet statistika-prodhues punojnë sipas kuadrove ligjore të ndryshme që përfshin, ligje (30%), VKM (15%), Udhëzime (5%), dhe Rregullore (8%)³³.

3.3.2 Funksionet dhe strukturat organizative

Kur bëhet fjalë për statistikën, ka një numër marrëveshjesh organizative në institucionet prodhuese të statistikave.. Në pjesën më të madhe të institucioneve, puna statistikore bashkohet me detyra të tjera, në vend të pasjes së një njësie organizative të specializuar për statistikën; në mënyrë domethënëse, "statistikën" më së shumti identifikohen në emrat e sektorëve; ministritë e kanë standardizuar këtë detyrë pak a shumë në Sektorin e Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave. Pesë nga institucionet kanë një njësi organizative të përkushtuar vetëm për statistikën. Në katër raste, puna statistikore bëhet nga një njësi organizative, por kjo njësi nuk identifikohen me emrin e "njësisë së statistikave". Në tre institucione, puna statistikore shpërndahet mes disa njësive organizative.

3.4 Çështje të sistemit

3.4.1 Konfidencialiteti

Mbrojtja e konfidencialitetit të informacionit gjatë grumbullimit, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave merret shumë në konsideratë nga prodhuesit. Më shumë se 90% e prodhuesve pohojnë se ata e mbrojnë konfidencialitetin e informacionit të grumbulluar për qëllime statistikore. Tre institucione i referohen Ligjit për Statistikat 2018 për mbrojtjen e konfidencialitetit. Pesë institucione i referohen specifikisht ligjit, urdhrave apo udhëzimeve që zbatohen për konfidencialitetin në institucionet e tyre.

3.4.2 2. Roli i Partnerëve për Zhvillim

Vetëm pak më shumë se një e treta e prodhuesve pohojnë se kanë marrë mbështetje nga Partnerët për Zhvillim. Mbështetja përfshin:

- a. ngritjen e një Baze të Dhënash për Azilkërkuesit (2018);
- b. krijimin e projektit për dixhitalizimin e shkollave "Sokrati" ("Socrates"), që do të mundësojë krijimin e databazës së plotë të sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat në vend;
- c. përpilimin e një buletini statistikor;
- d. kryerjen e një Ankete Gjurmimi Pas Arsimore dhe të Trajnimit Profesional;
- e. hapjen e një Portali Open Data (2016-2017);
- f. krijimin e Regjistrat Kombëtar Elektronik për Ndihmën Ekonomike (2014); Regjistrin Kombëtar Elektronik të Personave me Aftësi të Kufizuara (2017); dhe Regjistrin Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror; dhe
- g. trajnim për standardet, metodologjinë e përpunimit, grumbullimin e statistikave, nomenklaturave, metodologjinë për hartimin e anketave për raportin aftësi-nevoja; Klasifikimin

³³ Anketa e SALSTAT-it për institucionet, 2018

Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve dhe Problemeve që lidhen me Shëndetin (ICD-10) (2016-2017); anomali të lindura; dhe tregues të shëndetit.

3.5 Burimet

3.5.1 Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

Personeli

Institucionet statistika-prodhues kanë një numër të konsiderueshëm personelit statistikor . Ka institucione që nuk kanë të emëruar personel statistikor, sikundër dhe institucione që kanë rreth 120 punonjës që merren me statistikat. Niveli arsimor shpesh është grada Master.

Në përgjithësi, numri i personelit statistikor në organizatat prodhuese nuk ka ndryshuar përgjatë tre vjetëve të fundit.

Trajnimi

Rreth gjysma e institucioneve statistika-prodhues kanë raportuar për marrje trajnimi për “Njohuri bazë për statistikat zyrtare” organizuar nga INSTAT-i në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike. Trajnime të tjera të raportuara nga prodhuesit, priren të jenë specifike në lidhje me fushën e përgjegjësisë së institucioneve, p.sh., trajnim mbi përkufizimet dhe klasifikimet; krijimi dhe përditësimi i regjistrave; përgatitja e metadateve; nomenklaturat; mbledhja dhe paraqitja e informacionit, përpunimi i të dhënave statistikore; Indikatorët Evropianë Kryesorë të Shëndetit (European Core Health Indicators); anomali të lindura; dhe ICD-10.

Institucionet kanë renditur një numër temash për trajnimet e dëshiruara, që u duhen për përmirësimin e kapaciteteve të personelit statistikor. Temat më të perbashkëta të renditura, janë:

- a. statistikat zyrtare dhe sistemi statistikor;
- b. përkufizimet dhe protokollet ndërkombëtare;
- c. metodologjia, përpunimi dhe analiza e të dhënave në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it;
- d. softueret statistikore;
- e. metodat kryesore të përpunimit të të dhënave; dhe
- f. metodat aktuale dhe të reja për specialistët e statistikave në nivel qendror dhe rajonal.

Sipas institucioneve të intervistuar, performanca e personelit mund të përmirësohet, duke përmirësuar kualifikimet e personelit, trajnimet, sistemet TIK në përdorim dhe duke themeluar njësi organizative të specializuara për statistikat.

3.5.2 Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Prodhuesit e kanë vlerësuar mbështetjen e softuerit për aktivitetet statistikore mesatarisht, pak mbi nivelin 3 “Mirë”. në një shkallë niveli 1 në 5. Dy prodhues rendisin lehtësirat e softuerit në institucionet e tyre me “5-shkëlqyeshëm”. Vlerësimi për harduerin ishte i ngjashëm - pak më sipër 3-shit. Gjithashtu, dy institucione e renditën harduerin si “5-shkëlqyeshëm”; vetëm një prodhues dha vlerësimin “dobët” për harduerin në punën e vet statistikore. Pjesa më e madhe e prodhuesve bënë me dije se do të donin të shihnin përparim dhe zhvillim të

softuerit (rreth 76%) dhe harduerit (më shumë se 50%), në mënyrë që kjo të përmirësonte proceset statistikore.

3.5.3 Infrastruktura statistikore

Prodhuesit më së shumti kanë sugjeruar se fushat më kritike dhe që kanë nevojë për përmirësime, janë (sipas shpeshtësisë së përmendjes):

- Udhëzimet për përdorimin e metadatave /dokumentimin e punës teknike;
- Databazat që përmbajnë metadatën që përpunojnë udhëzimet, praktikën më të mira, etj., për të lejuar përdorimin e lehtë të sistemeve;
- Dijeni mbi metodat shkencore të pranuar dhe zbatimin e tyre; dhe
- Manualët dhe udhëzimet për grumbullimin, futjen dhe përpunimin statistikor.

3.6 Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet

70% e institucioneve rendisin personelin statistikor si kufizimin kryesor në punën e tyre aktuale. Probleme të tjera që janë raportuar, përfshijnë: mungesë softueri, TIK të vjetëruar dhe të papërshtatshëm, ndërtrim të shpeshtë personeli, mungesë trajnime të përshtatshme, mungesa e kompjuterave personale, emërim personeli me arsim të papërshtatshëm, buxhet i ulët ose i pamjaftueshëm për kryerjen e trajnimeve/udhëzimeve/anketave.

Prodhuesit kanë sugjeruar zgjidhjet e mëposhtme:

- trajnim dhe arsim që çon në kualifikim në nivel qendror dhe lokal;
- trajnim i vazhdueshëm i personelit në fushën e përpunimit statistikor, si dhe njohuri për përditësimet më të fundit të softuereve ose metodologjitë për statistikat, në nivel qendror dhe lokal;
- përgatitje të manualeve për standardet e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave statistikore;
- INSTAT-i të luajë një rol më të rëndësishëm në trajnime, përgatitjen e udhëzuesve dhe krijimin e sistemeve të ndryshme që ndihmojnë prodhuesit në punën e tyre;
- bashkëpunimi i Partnerëve për Zhvillim për shpërndarjen e praktikave të mira të përcaktuara dhe për ndërmarrjen e studimeve të ndryshme; dhe
- krijimin e njësive organizative të specializuara, përgjegjëse për statistikat në institucionet statistika-prodhues.

3.7 Të dhëna administrative në dispozicion

Shumë prej prodhuesve treguan se kishin të dhëna administrative që kanë menduar se do të jenë me interes dhe vlera për INSTAT-it, me mundësi përpunimi dhe publikimi si statistika.

Kapitulli 4

Vlerësimi i institucioneve që janë ofrues të të dhënave administrative për qëllime statistikore

Përveç vlerësimit të SKS-së (INSTAT, BSH dhe MFE) dhe institucioneve të tjera statistika-prodhues, u bë edhe një vlerësim në lidhje me institucionet që ofrojnë të dhëna administrative për qëllime statistikore³⁴. Vlerësimi shqyrtoi disa sfera kryesore si vijon (të cilat shqyrtohen gjithashtu edhe në vlerësimin e SKS-së):

4.1 Plotësimi i nevojave të përdoruesit

4.1.1 Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore për statistika

Prodhuesit evidentojnë boshllëqe, probleme dhe mangësi në RA (rekorde administrative) dhe në përmbushjen e kërkesave të përdoruesve: ato përfshijnë cilësinë, detajet (disagregimin), dorëzimin në kohë dhe mbulimin. Evidentohet si problematike gjithashtu dhe periodiciteti, por më pak.

Rreth një e pesta e institucioneve pohoi se mund të kenë të dhëna që mund të përdoren më tej për të gjeneruar statistika. Institucionet mund të kenë nevojë për ndihmën e INSTAT-it me këto grupe të dhënash, për t'ë aftësuar personelin ti përpunojë të dhënat dhe të publikojë statistikën. Ndihma mund të përfshijë edhe procedura metodologjike dhe statistikore.

4.1.2 Statistikat e disagreguara (statistikat lokale dhe disagregime të tjera)

Pothuajse të gjitha institucionet pohojnë nevojën për të përmirësuar dhe shtuar RA-të e tyre kudo që është e mundur me disagregimet sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, etnisë, statusit migrator, si dhe karakteristikave të tjera. Një numër i konsiderueshëm institucioneve beson se mund të ketë vend për më shumë disagregim krahasuar me disagregimet aktuale. Gjithsesi, pjesa më e madhe e institucioneve nuk ka plane aktuale për të zgjeruar disagregimin, por shpreh vullnetin për të bashkëpunuar me INSTAT-in. Ata pohojnë se ky proces mund të shkojë përpara me iniciativën dhe mbështetjen e INSTAT-it.

4.1.3 Shpërndarja

RA-të vihen kryesisht në dispozicion të INSTAT-it (dhe institucioneve të tjera) për prodhimin e statistikave, në përgjithësi sipas memorandumeve të firmosura të mirëkuptimit.

³⁴ Vlerësimi është bërë nga 23 prill-09 maj 2019. Kryesisht, u bë në bazë të pyetësorëve të printuar që iu dërguan me postë institucioneve, ku iu bashkangjitën më pas intervistat ballë për ballë, me telefon dhe me e-mail. Morën pjesë njëzet e një mbajtës rekordesh administrative (shih 8.2 Shtojca II për më shumë hollësi). Informacioni u përftua kryesisht prej drejtorëve, krerëve të sektorëve dhe specialistëve. Në përgjithësi, të gjithë institucionet iu përgjigjën të gjitha pyetjeve në pyetësor. Intervistat u drejtuan nga një Këshilltar Kombëtar shqipfolës, me përvojë të madhe në statistikën kombëtare dhe me njohuri shumë të mira në metodat kërkimore sasiore dhe cilësore.

4.2 Çështje të prodhimit të statistikave

4.2.1 Burimi i të dhënave

Burimet kryesore të RA-ve për pjesën më të madhe të institucioneve janë raportet/skedarët nga zyrat lokale të institucioneve. Përveç këtij raportimi vertikal brenda institucioneve, disa institucione marrin RA nga institucione të tjera.

Pothuajse një e treta e institucioneve tregon se grumbullimi i të dhënave dhe përpunimi i tyre bazohet mbi standardet. Disa institucione të tjera e bazojnë punën e tyre të përditshme mbi praktikën e krijuar dhe mbi komunikimin/këshillat nga INSTAT-i. Të intervistuar të tjerë ndjekin VKM-të respektive ose kuadrin ligjor që përfshin edhe PKSZ 2017-2021, të cilat përcaktojnë qartë periudhën e raportimit, metodën e raportimit dhe shpeshtësinë e këtij raportimi.

Pjesa më e madhe e institucioneve nuk ka manualë për nxjerrjen përpunimin e RA-ve; disa ndjekin kuadrin e vet përkatës ligjor. Megjithatë, rreth 20% e institucioneve ka manualë për proceset prodhuese të RA-ve.

Pjesa më e madhe e institucioneve tregon se RA-të e tyre përmbajnë një fushë unike identifikuese, p.sh., Numrin Unik Identifikues (NUIS) (Numri Unik i Identifikimit të Subjektit), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për çdo person fizik apo kompani të regjistruar për të bërë biznes, Numrin Personal të Identitetit (NID) lëshuar nga Regjistri Kombëtar elektronik i Gjëndjes Civile. Përveç këtyre, nuk është evidentuar fushë tjetër unike identifikuese në të dhënat, që të përdoret nga institucionet.

4.2.2 Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

Vetëm pak nga institucionet zbatojnë standarde, koncepte, klasifikime dhe praktika ndërkombëtare në RA-të e tyre. Institucionet tjera ndjekin marrëveshjet kombëtare ligjore dhe institucionale, si dhe memorandumet e mirëkuptimit me INSTAT-in.

4.2.3 Çështje të cilësisë

Të përgjithshme: Pjesa më e madhe e institucioneve nuk ka udhëzime të brendshme mbi procedurat/metodat statistikore për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar cilësinë e RA-ve të tyre, por kanë disa praktika në përdorim të cilat japin kontribut në cilësi. Disa institucione për metodologjinë statistikore zbatojnë udhëzime institucionale.

Raportet mbi cilësinë: Institucionet nuk kanë nxjerrë raporte për cilësinë e RA-ve.

4.2.4 Metadata

Zakonisht, metadat nuk janë të zhvilluara në lidhje me të dhënat administrative.

4.3 Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

Ligjet përkatëse të cilat janë të zbatueshme për secilin institucion, ofrojnë kuadrin ligjor për grumbullimin e të dhënave administrative.

4.4 Çështje të sistemit

4.4.1 Konfidencialiteti

Të gjithë institucionet vënë në dukje se e ruajnë konfidencialitetin e burimit të informacionit që grumbullohet në përputhje me kornizat e ndryshme ligjore dhe institucionale sipas të cilëve ata veprojnë, si: Ligji për Statistikat 2018; dhe ligjet “për të drejtën e informimit”; “për mbrojtjen e të dhënave personale”; “për regjistrimin e bizneseve”; dhe ligjit “për sekretet shtetërore” dhe aktet nënligjore të tij.

4.4.2 Roli i Partnerëve për Zhvillim

Sipas intervistave, raportohe ndihmë e pakët e lidhur drejtpërdrejt me grumbullimin dhe përpunimin e RA-ve. Megjithatë, një numër institucioneve ka marrë asistencë teknike në lidhje me fushat respektive të statistikave të tyre, gjë që ka pasur edhe njëfarë ndikimi në punën me RA-të (shih në paragrafin 3.4.2 Roli i Partnerëve për Zhvillim, më sipër).

4.5 Burimet

4.5.1 Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

Pak më pak se një e treta e institucioneve kanë raportuar se personeli i tyre përgjegjës për statistikën/RA-të ka arsimin dhe trajnimin e duhur, edhe pse kjo është më pak e vërtetë në nivel lokal. Institucione të tjera raportojnë se personeli ka arsim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm, por ka mungesë trainimesh.

Institucionet janë shprehur se personeli nuk ka marrë trainime për RA-të. Rreth një e katërta raportoi trainimin e organizuar nga INSTAT-i në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike për “Njohuritë Bazë për Statistikat Zyrtare”. Një pjesë e personeli është trainuar drejtpërdrejt në INSTAT për standardizimin e përpunimit të të dhënave.

Thuajse gjithë institucionet janë shprehur se kishin nevojë për trainime; temat përfshinin mbledhje të dhënash, krijim të RA-ve, përditësim regjistrash, përpilim statistikash, përgatitje metadatash, proceset e punës, përmirësim në raportim, si dhe përmirësim në përgatitjen për të dhënat.

4.5.2 Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Përshtatshmëria e infrastrukturës fizike dhe TIK për RA-të është mjaft e përzier. Rreth gjysma e institucioneve vlerëson se mbështetja me softuere dhe harduere në dispozicion të punës së RA-ve është ‘Shumë e mirë’ ose ‘E shkëlqyer’. Institucionet e tjera e vlerësojnë atë nga ‘dobët’ në ‘mirë’. Institucionet që e vlerësojnë mbështetjen si ‘Shumë të mirë’ ose ‘Të shkëlqyer’ përfitojnë nga sistemet që kanë në përdorim, TIK më të fundit dhe paketa softueresh të dedikuara.

4.6 Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet

Kufizimet dhe problemet e identifikuara, janë: Personel jo i mjaftueshëm: personel i paarsimuar dhe i patrainuar si duhet për të punuar me RA-të; TIK i vjetëruar dhe i papërshtatshëm.

Në vijim janë zgjidhjet që kanë shprehur institucionet:

- a. shtimi i personelit dhe investimi në trainime të përshtatshme; kualifikimi duhet të mbulojë (përveç kualifikimit të përmendur më sipër në paragrafin 4.5.1 Personeli, kualifikimet dhe zhvillimi,) i) teknika dhe metodologji të reja të përpunimit të të dhënave, analizimit dhe interpretimit të tyre; ii) ndërtim të bazës së të dhënave; iii) monitorim të cilësisë dhe kontroll dhe përmirësim; iv) përkufizime të të dhënave dhe treguesve; v) standarde dhe protokolle ndërkombëtare; dhe vi) hartimin e një depoje të dhënash [data warehouse]. Në veçanti, fokusi duhet të vihet në personelin e ri të emëruar, si dhe në zyrat lokale të cilat janë burimi primar i RA-ve;
- b. trainim të mëtejshëm dhe përmirësime në metodologji nga INSTAT-i;
- c. krijimi i përkufizimeve më të mirë të të dhënave (për të përmirësuar raportimin e të dhënave) dhe përmirësimi i bazave të të dhënave;
- d. fuqizimi i sistemeve dhe strukturave të TIK dhe
- e. rishikimi i formateve të standardeve dhe akteve nënligjore për t'iu përshtatur ndryshimeve ligjore.

Institucionet kanë renditur si vijon nevojat për mbështetje:

- a. zbatimi i metodologjive, koncepteve dhe përkufizimeve ku ndeshen probleme ose ku është planifikuar të paraqiten përditësime.
- b. Rishikimi i formave të grumbullimit të të dhënave për të përmirësuar grumbullimin e të dhënave bazë;
- c. Ndërtimi i manualëve dhe udhëzuesve për grumbullimin, futjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, si dhe udhëzuesve për përgatitjen e metadatave.

Kapitulli 5

Kuadri Strategjik i propozuar për SZHSKS

5.1 Misioni

Misioni i SKS-së është të sigurojë statistika transparente, neutrale dhe në kohën e duhur, të cilat ndihmojnë përdoruesit të gjykojnë zhvillimin dhe proceset transformuese në fushën e ekonomisë, demografisë, shoqërisë dhe mjedisit, brenda vendit³⁵.

5.2 Vizioni

Vizioni i SKS-së është të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira për të përfutur statistika dhe tregues, të cilëve janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.

5.3 Vlerat³⁶

Profesionalizëm: Besueshmëri - Objektivitet - Bashkëpunim dhe Komunikim - Identifikim me INSTAT-in - Orientim ndaj përdoruesit - Orientim ndaj Cilësisë - Orientim ndaj Zgjidhjes – Ndërmarrje iniciativash – Përgjegjësi. Vendim-marrës bazuar në vlerësimet teknike dhe statistikore; Zbatues i metodologjive statistikore, përkufizimeve, klasifikimeve, metodave të pranuar ndërkombëtarisht; burim të dhënash dhe teknologji të përshtatshme.

Profesionalizëm: Besueshmëri - Objektivitet - Bashkëpunim dhe Komunikim - Identifikim me INSTAT-in - Të orientuar drejt përdoruesit - Orientim ndaj Cilësisë - Orientim ndaj Zgjidhjes – Marrje iniciativash – Përgjegjësi. Marrje vendimesh bazuar në vlerësimet teknike dhe statistikore; Zbatim metodologjish statistikore, përkufizimesh, klasifikimesh, metodash të pranuar ndërkombëtarisht; si dhe burime të dhënash dhe teknologji të përshtatshme.

Integritet: Kryerja e detyrave sipas standardeve më të larta morale dhe etike; sjellja është e paanshme; dhe zhvillimi, prodhimi dhe shpërndarja e statistikave bëhet në mënyrë objektive; ruhet konfidencialiteti i informacionit individual.

Motivim: Përfshirje në procese - Fleksibilitet - Dhënie e feedback-ut – Stabilitet-Ndërmarrje iniciativash.

Partneriteti/punë në grup: Respekt ndaj njëri-tjetrit - Dinjitet - Barazi - Respekt ndaj mendimit ndryshe - Mbështetje ndaj njëri-tjetrit - Shkëmbim njohurish - Qasje aktive ndaj punës në grup dhe në mënyrë të koordinuar me kolegët në SKS.

Fokusi i Shërbimit: Vendosja e asaj çfarë duan përdoruesit; Të qenit i orientuar drejt përdoruesit; Përpjekje për të dorëzuar produktin; mirëmbajtja e respektit dhe mirësjelljes ndaj përdoruesve.

³⁵ Nga Ligji për Statistikat 2018, Neni 14 i ndryshuar, për të zgjeruar mbulimin në institucione dhe fusha të statistikave).

³⁶ Përshtatur më së shumti nga Strategjia e Zhvillimit të INSTAT-it, 2017-2030, fq.2-3

5.4 Objektivat

1. Të zhvillohet SKS për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit Evropian
2. Të plotësohet niveli i plotë i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare
3. Të prodhohen statistika zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar Evropiane dhe ndërkombëtare
4. Të përfshihen institucione shtesë statistika-prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare
5. Të modernizohen më tej proceset, metodat, produktet dhe shërbimet statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare
6. Të përftohet besim i lartë publik në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur

5.5 Nën-objektivat dhe Strategjitë

Nën-objektivat janë përcaktuar sipas secilit Objektiv; gjithashtu, është bërë edhe një përzgjedhje Strategjish sipas secilit Objektiv, që parashikohet të drejtojë arritjet e Objektivave dhe Nën-objektivave.

1 Të zhvillohet SKS në përputhje të plotë me *acquis communautaire* në lidhje me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritimit evropian

Nën-objektivat

- a. Të vendosë kërkesat që do të mundësojnë progresin drejt *acquis*
- b. Të sigurojë pavarësinë profesionale të të gjithë prodhuesve të statistikave zyrtare
- c. Të prodhojë gjithë indikatorët përkatës sipas specifikimeve në Përmbledhjen e Kërkesave Statistikore të Eurostat-it

Strategjitë

- e. Të bëjë të njohur ligjet e reja, rregullat dhe procedurat si dhe të rishikojë ato ekzistueset, sipas nevojës
- f. Të bëjë të njohur seritë e reja statistikore dhe të ndryshojë ato që prodhohen aktualisht, në përputhje me *acquis* në statistika
- g. T'i përcjellë statistikat e kërkuara Eurostat-it
- h. Të bëjë të njohura metodologjitë/politikat/dokumentet/rregulloret/udhëzimet e detyrueshme në lidhje me statistikat zyrtare
- i. Të reklamojë aprovimin nga Qeveria e Shqipërisë të Deklaratës së Angazhimit për Besimin në Statistikat Zyrtare.
- j. Të vazhdojë të zbatojë rekomandimet përkatëse nga „*Peer Review*” dhe Raportet e Progresit të Bashkimit Evropian

2.2. Të plotësohet niveli i plotë i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare

Nën-objektiva

- a. Të rritet përdorimi i të dhënave dhe rekordeve administrative për qëllime statistikore
- b. Të prodhohen tregues që të përputhen me nevojat e përdoruesve të brendshëm/vendorë të statistikave
- c. Të prodhohen tregues që të përputhen me nevojat e përdoruesve ndërkombëtarë të statistikave
- d. Të ofrohet qasje e lehtësuar në statistikat zyrtare për të gjithë përdoruesit në një gamë të përshtatshme formatesh dhe sipas praktikave ndërkombëtare

Strategjitë

- k. Të mbajë marrëdhënie të mira me ofruesit e të dhënave të papërpunuara (të intervistuarit në anketime dhe mbajtësit e të dhënave administrative)
- l. Të shfrytëzojë gjithë burimet e mundshme të të dhënave
- m. Të garantojë që të jetë në dispozicion infrastruktura statistikore kryesore: d.m.th. databazat për të mbajtur të dhënat statistikore të jenë të gatshme për prodhimin e rezultateve; kuadrin e zgjedhjes e kampionit; manuale dhe dokumentime; listimin e standardeve
- n. Të zbatojë standarde dhe praktika të pranuar ndërkombëtarisht
- o. Të përmirësojë statistikat e disagreguara, përfshirë dhe statistikat në nivel lokal
- p. Këshilli i Statistikave të ushtrojë përgjegjësitë e tij të plota për të garantuar që PKSZ (2017-2021) "të pasqyrojë nevojat parësore të përdoruesve për informacion statistikor"³⁷
- q. Të zbatojë Politikat e Open Data (të dhënat në format dhe licencë të hapur)³⁸
- r. Të jetë në përputhje me Sistemin e Përmirësuar të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së
- s. Të përdorë për shpërndarje një kombinim të përshtatshëm të rezultateve të printuara, faqeve të internetit, email-eve, si dhe rrjeteve sociale
- t. Të lehtësojë qasjen ndaj produkteve të të gjithë prodhuesve të statistikave përmes faqes së internetit të INSTAT-it; një databazë të integruar të të gjitha fushave të statistikave; të përmirësojë funksionin e shërbimit ndaj klientit
- u. Të përfshijë më shumë karakteristika në prezantime si grafikë, tabela, të dhëna të derivuara dhe tekste analitike

3.3. Të prodhohen statistika zyrtare të një cilësie të lartë, që përputhen me standardet e pranura evropiane dhe ndërkombëtare

Nën-objektiva

³⁷ Ligji për Statistikat 2018, Neni 21 a)

³⁸ Të dhënat e hapura është ideja që disa të dhëna duhet të jenë të disponueshme lirisht ndaj kujtdo për t'i përdorur dhe ribotuar sipas dëshirës, pa detyrime të drejtash autori, patente apo mekanizmi tjetër kontrolli. Qëllimi i lëvizjes për të dhëna të hapura është i ngjashëm me atë të lëvizjeve të tjera "të hapura" siç janë burimet e hapura, sistemet (hardware) e hapura, përmbajtje të hapura, si dhe qasje e hapur. Shih gjithashtu <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/open-data>

- a. Të përmirësohet cilësia e të dhënave dhe rekordeve administrative të siguruara nga institucionet përkatëse
- b. Të ndërtohet, mirëmbahet dhe promovohet menaxhimi i cilësisë dhe sistemi i kontrollit të cilësisë për SKS-në

Strategjitë

- v. Të punohet me mbajtësit e të dhënave dhe rekordeve administrative për të zbatuar sigurimin e cilësisë për të dhënat dhe rekordet administrative
- w. Të përdoren instrumentat e sigurimit të cilësisë dhe të krijimi i sistemeve audituese për cilësinë statistikore
- x. Të aplikohen standarde dhe praktika të pranuar ndërkombëtarisht

4 Të përfshihen institucione statistika-prodhues të tjerë në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare

Nën-objektiva

- a. Të rritet ndërgjegjësimi i institucioneve për përfitimet si rezultati i funksionimit brenda PKSZ
- b. Të vendoset dhe përmirësohet bashkëpunimi dhe partneriteti mes institucioneve statistika-prodhues
- c. Institucionet statistika-prodhues të vendosin rregullatorë institucionale që të jenë në mbështetje të funksioneve statistikore

Strategjitë

- y. T'u krijohe qasje institucioneve statistika-prodhuese për t'i bindur që të përfshijnë programet e tyre në PKSZ
- z. Të qartësohen rolet/mandatet e secilit prodhues të statistikave
- aa. Të përmirësohen mekanizmat koordinues për sa i përket statistikave zyrtare dhe jo-zyrtare
- bb. Të hartohet një plan vjetor i koordinuar për të gjitha anketat statistikore
- cc. Të përmirësohet koordinimi në nivel lokal
- dd. Të zgjerohen kontaktet me ministritë dhe prodhues të tjerë të statistikave
- ee. Të prezantohen struktura institucionale të kërkuara/ rekomanduara - p.sh., të formalizohet Komiteti i Prodhuesve të Statistikave Zyrtare
- ff. Të promovojë përmirësimet profesionale dhe organizative në institucionet statistika-prodhuese, përfshirë edhe krijimin e njësive organizative mbështetëse të specializuara, përgjegjëse për statistikat

5.5. Të modernizohen më tej proceset, metodat, produktet dhe shërbimet statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe kosto-efektivitetin e statistikave zyrtare

Nën-objektiva

- a. Të modernizohen më tej sistemet për grumbullimin e të dhënave
- b. Të zgjerohet përdorimi i burimeve jo-tradicionale të të dhënave të papërpunuara
- c. Të modernizohen më tej sistemet për përpunimin statistikor dhe ruajtjen dhe shpërndarjen

- d. Të fuqizohet bashkëpunimi me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja, produkteve dhe shërbimeve statistikore
- e. Të zhvillohen sisteme informacioni për të reduktuar ngarkesën e komunikimit dhe për të rritur cilësinë statistikore

Strategjitë

- gg. Të prezantohet/zgjerohet përdorimi i aplikimeve të të teknologjisë së re për grumbullimin e të dhënave dhe mundësitë e shfrytëzimit për të përdorur *Big Data*
- hh. Të shtrihet zbatimi i Modelit të Procesit të Biznesit të Përgjithshëm Statistikor (GSBPM) në SKS
- ii. Të përditësohen dhe prodhohen manualë të rinj për gjithë proceset e prodhimit statistikor
- jj. Të harmonizohen standardet, konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe metodat/praktikat e mira statistikore në SKS

6.6. Të arrihet besim i lartë i publikut në SKS dhe njohja e tij si një grup institucioneve të pavarura profesionalisht e me performancë të duhur

Nën-objektiva

- a. Të përftohet një rritje e përdorimit dhe njohurive të produkteve statistikore të SKS-së
- b. Të fuqizohet dhe promovohet roli i INSTAT-it në SKS, në rajon dhe arenën ndërkombëtare
- c. Të zbatohen plotësisht dispozitat ligjore dhe praktike për të mbrojtur konfidencialitetin statistikor

Strategjitë

- kk. Të nxirret një Kalendar i Publikimit Paraprak për publikimin e statistikave zyrtare
- ll. Të publikohen shënime/metadata teknike të përshtatshme në të gjithë publikimet e statistikave zyrtare
- mm. Të vazhdohet të mbahen konferenca për shtyp për të publikuar seritë e statistikave zyrtare
- nn. Të përmirësohet shpërndarja dhe shërbimi i klientit
- oo. Të promovohet ndërgjegjësimi për statistikën të ndërmerret mbështetje
- pp. Të rriten kontaktet me përdoruesit në një gamë procesesh statistikore, përfshirë edhe planifikimin dhe shpërndarjen
- qq. Të sigurohet zbatimi i parimit të konfidencialitetit statistikor dhe kjo të publikohet

Strategjitë që zbatohen në një grup objektivash:

- rr. Mbështetje për të rritur anafazhimin politik ndaj statistikave
- ss. Të zbatohet një program “ndrysho menaxhimin/change management”
- tt. Të plotësojë (pas një vlerësimi të burimeve njerëzore) dhe të zhvillojë burimet njerëzore (trajnim dhe zhvillim)
- uu. Të planifikohet karriera brenda SKS-së – të zhvillohet një shërbim statistikor i integruar
- vv. Të përmirësohet pagesa

ww. Të përmirësohet infrastruktura fizike dhe të aplikohen sisteme të përshtatshme TIK, harduere dhe softuere (por sidomos sipas Objektivave 2, 3, dhe 5 më sipër, si dhe 5.6 kosto-efektiviteti)

xx. Të zgjerohen dhe përmirësohen statistikatat gjeo-hapësinore

5.6 Efiçenca në kosto

Të gjitha strategjitë duhet të zbatohen me vëmendjen e duhur ndaj iniciativave kost-efektive Kjo mund të arrihet duke:

- a. U siguruar që menaxhuesit vendim-marrës t'u japë vëmendjen e duhur nevojës për efiçencë në kosto
- b. Krijuar kulturë pune që vë theksin në efiçencën në kosto
- c. U siguruar që personeli të përftojë aftësiqë do t'i mundësojë të vërë në funksion përgjegjësitë e veta me efiçencë

Strategjitë specifike për të përftuar efiçencë në kosto përfshijnë:

- yy. Përzgjedhja e burimeve të të dhënave dhe metodat e përpunimit që marrin në konsideratë kostot
- zz. Prezantimi i projektit dhe menaxhimit të procesit efektiv
- aaa. SKS të punojë në një mënyrë bashkëpunuese, duke shmangur mbivendosjet dhe duke siguruar përshtatjen e zgjidhjeve të përbashkëta
- bbb. përmirësimin e strukturës organizative dhe menaxhimit, duke përfshirë edhe delegimin e autoritetit
- ccc. Kualifikime specifike të personelit mbi rëndësinë e efiçencës në kosto dhe mbi qasjet kosto-efektive.

Kapitulli 6

Menaxhimi i SZHSKS-së

Menaxhimi i SZHSKS-së do të synojë përfshirjen e plotë të institucioneve statistika-prodhues, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme, zbatim, monitorim dhe raportim, rishikim dhe vlerësim, si dhe menaxhim risku.

6.1 Mbulim i plotë

Synimi është të fusë të gjithë prodhuesit e statistikave qeveritare në SZHSKS për të siguruar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit statistikor. INSTAT-i do të vazhdojë të punojë me ato institucione që nuk janë mbuluar fillimisht nga SZHSKS, me pritshmërinë që të mund të përfshihen me kalimin e kohës, mundësisht që gjatë vitit të parë.

6.2 Sigurim i mbështetjes së vazhdueshme

SZHSKS duhet të mirë-promovohet në qeveri, në mënyrë që të mbahet një mbështetje e qëndrueshme afatgjatë nga qeveria; politikëbërësit duhet të mbahen të informuar për arritjet e bëra në kuadër të SZHSKS-së. Palë të tjera të interesuara, përfshirë edhe publikun, duhet të mbahen gjithashtu të informuara për të krijuar një mbështetje me bazë të gjerë për vazhdimësinë në SZHSKS.

Partnerët për Zhvillim gjithashtu duhen mbajtur të informuar, për arsye se mbështetja e tyre e qëndrueshme afatgjatë do të jetë thelbësore; kjo mund të arrihet përmes një serie raportesh dhe takimesh të rregulltadhe subjekti duhet të jetë pjesë në mbledhjet e rregullta vjetore me Partnerët për Zhvillim. Duhet bërë një rishikim i detajuar i mbështetjes teknike dhe financiare, që do të jetë i nevojshëm për zbatimin e SZHSKS-së dhe të diskutohet me Partnerët për Zhvillim për të krijuar një kontribut të koordinuar dhe domethënës nga Partnerët për Zhvillim me SZHSKS-në.

Është propozuar që SZHSKS të vendoset në faqen e internetit të INSTAT-it, ku do të jetë e vlefshme për të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe publikun. Është propozuar gjithashtu që progres-raportet të publikohen në faqen e internetit të INSTAT-it për informimin publik.

6.3 Menaxhimi i SZHSKS-së

6.3.1 Bordi Këshillues

Do të jetë e nevojshme mbikëqyrja e zbatimit të SZHSKS-së. Mbikëqyrja do të përfshijë një monitorim të përgjithshëm dhe rishikim të progresit, duke rekomanduar ndryshime në Planet Strategjike dhe të Veprimit kur të jetë e nevojshme, dhe duke vënë në lëvizje mbështetjen e qeverisë dhe atë publike. Mbikëqyrja do të ketë natyrë këshilluese, duke rezultuar në këshillim për i) INSTAT-in në lidhje me zbatimin prej tij të Planeve të Veprimit dhe rolit të tij si koordinues dhe drejtues i SZHSKS-së dhe ii) këshillim për institucionet e tjera të përfshira në SZHSKS. Disa borde ekzistuese janë konsideruar si ofrues potencialë të kësaj mbikëqyrjeje, p.sh., Këshilli i Statistikave dhe Komiteti i Produktit të Statistikave Zyrtare. Megjithatë, këta nuk kanë anëtarësi të përshtatshme. Ndaj dhe është propozuar të ngrihet një Bord Këshillues i specializuar për SZHSKS-në, që të përfaqësojë gamën e plotë të palëve të interesuara me interes në statistika dhe SZHSKS (prodhues, përdorues,

media, bota akademike, ofrues të të dhënave administrative dhe Partnerët për Zhvillim). Ky Bord duhet të drejtohet nga DP i INSTAT-it dhe të pasqyrojë rëndësinë e SZHSKS-së për INSTAT-in, SKS-në dhe më tej. Ky Bord duhet të marrë raporte për zbatimin e SZHSKS-së për të qenë plotësisht i informuar dhe të ketë mundësinë të ofrojë pkontributin e tij në këtë proces.

6.3.2 Ekipi i menaxhimit

Është propozuar që INSTAT-i të caktojë një titullar të lartë si Koordinator të SZHSKS-së për të bërë koordinimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SZHSKS-së si dhe funksione të tjera sipas nevojës; ai do të jetë dhe titullari inisiator për ndryshime të mundshme të rekomanduara nga Bordi Këshillues. Koordinatori duhet të jetë një zyrtar i lartë me përvojë të mëparshme në menaxhim projekti. Meqë zhvillimi i SKS-së ka gjasa të përbëjë një element të rëndësishëm të SZHSKS-së, Koordinatori do të duhet të ketë njohuri për i) Ligjin për Statistikat 2018 dhe zbatimin e tij, ii) strukturat qeverisëse që janë ngritur për mbështetjen e SKS-së, dhe iii) kërkesat e acquis në statistika. Është propozuar gjithashtu edhe një Menaxher i Sistemit të Monitorimit, që do të ketë detyrën të menaxhojë sistemin monitorues dhe raportues, përfshirë grumbullimin dhe futjen e të dhënave, përpunimin dhe shkrimin e raportit. Mund gjithashtu të kërkohet personel shtesë, në varësi të shkallës dhe larmisë së detyrave, që do të përcaktohen kryesisht nga numri dhe përbërja e institucioneve që do të marrin pjesë në SZHSKS (përmes hartimit dhe zbatimit të Plan Veprimeve). Koordinatori dhe personeli duhet të vendosen me zyra brenda njësisë organizative ekzistuese të përshtatshme të INSTAT-it.

Është propozuar një Njësi e Zbatimit, Monitorimit dhe Raportimit (IMRT), e cila do të ofrojë, në nivel operacional, një shkallë të gjerë mbështetjeje për zbatimin e SZHSKS-së. IMRT do të jetë përgjegjëse për të garantuar zbatimin e duhur të SZHSKS-së dhe do ta ushtrojë këtë përgjegjësi përmes një sistemi monitorimi dhe raportimi. Pritet që IMRT të përfshijë persona që kanë shërbyer dhe aktualisht shërbejnë në Grupin e Punës për SZHSKS në vazhdimësi.

Është propozuar që IMRT të ketë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- ddd. Të shërbejë si pika kyçe e çështjeve operationale në lidhje me SZHSKS-në;
- eee. Të ndërmarrë veprime për të rritur ndërgjegjësimin e palëve të interesuara rreth SZHSKS-së;
- fff. Të garantojë zbatimin e duhur të SZHSKS-së, p.sh., zbatimin e Planeve të Veprimit, duke ndjekur rregullisht institucionet përgjegjëse për zbatimin;
- ggg. Të projektojë, mirëmbajë, si dhe të zbatojë rregullisht një sistem efektiv për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planeve të Veprimit, përfshirë edhe indikatorët e progresit, të mbajë DP të INSTAT-it, Bordin Këshillues të SZHSKS-së dhe palë të tjera të interesuara të informuar për progresin;
- hhh. Të ndërmarrë veprime për të rritur ndërgjegjësimin e monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planeve të Veprimit;
- iii. Të studiojë dhe vendosë mbi një platformë të përshtatshme për monitorimin dhe raportimin;
- jjj. Të këshillojë sipas kërkesave institucionet pjesëmarrëse në SZHSKS për zbatimin e Planeve të Veprimit;
- kkk. Të porositë dhe të marrë progres-raporte për Plane individuale Veprimi, sipas nevojës, dhe t'ia ofrojë këto raporte DP të INSTAT-it dhe Bordit Këshillimor të SZHSKS, si dhe t'u ofrojë informacionin (*feedback-un*) e duhur institucionit/eve raportuese; dhe

- III. Të përpilojë informacion të përmbledhur dhe shpjegues për zbatimin sipas kërkesës nga DP i INSTAT-it dhe Bordit Këshillues të SZHSKS-së.

6.3.3 Përbërja e IMRT

IMRT duhet të drejtohet nga një zyrtar i lartë i INSTAT-it, në mënyrë që të mbështesë ndërveprimin efektiv me palët e interesuara, në veçanti me institucionet statistika-prodhues përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin e Planeve të Veprimit.

Është propozuar që IMRT të përfshijë Koordinatorin e SZHSKS-së dhe tre apo katër zyrtarë të tjerë të lartë, që të ofrojnë njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

- mmm. Njohuri themelore të statistikave, pasi pritët të propozohen dhe të zbatohennjë numër i madh i Planeve të Veprimit, duke përfshirë edhe prodhimin e statistikave.
- nnn. Njohuri dhe aftësi në TIK, sepse strategjitë e TIK me gjasë do të jenë pjesë integrale e shumë Planeve të Veprimit.
- ooo. Burimet njerëzore/trainimet dhe zhvillimet, sepse politikat e burimeve njerëzore, trainimet dhe strategjitë e hartimit ka gjasë të kërkojnë për të mbështetur shumë nga Planet e Veprimit.
- ppp. Aftësi në Planifikimin Strategjik dhe Koordinim, sepse institucionet mund të kërkojnë këshilla rreth planifikimit dhe koordinimit mes institucioneve, me qëllim zbatimin maksimal të Planeve të Veprimit.

Ndërkohë që Koordinatorin e SZHSKS-së mund të jetë i përkushtuar me kohë të plotë ndaj punës dhe pjesëmarrjes në IMRT, pritshmëria është që pjesëtarët e tjerë të Ekipit të marrin përgjegjësitë e tyre në këtë Ekip si detyrë shtesë mbi detyrimet e tyre aktuale.

6.3.4 Zbatimi

Çdo institucion i SKS-së do të jetë përgjegjës për zbatimin e Planeve të Veprimit që ka zhvilluar në kontekstin e SZHSKS-së. Më e mira e mundshme do të ishte që Plani i Veprimit të plotësohej nga një plan veprimi vjetor i detajuar në fillim të çdo viti, bazuar në Planet e Veprimit në SZHSKS. Planet vjetorë të Veprimit do t'i raportohen rregullisht INSTAT-it.

INSTAT-i do të jetë përgjegjës për Planin e tij të Veprimit dhe do të ketë gjithashtu përgjegjësinë për drejtimin dhe koordinimin e kompleksit të punës që përfshin Planet e Veprimit të institucioneve, si pjesë normale e përgjegjësi të veta të koordinimit.

SZHSKS duhet të promovohet mirë brenda personelit të të gjithë institucioneve statistika-prodhues, për të gjeneruar mbështetje nga personeli i të gjitha niveleve në këto institucione; një mbështetje e tillë me bazë kaq të gjerë do të ishte thelbësore për suksesin e SZHSKS-së. Do të ketë programe dhe komunikime specifike, që do të informojë dhe aktivizojë personelin për zbatimin e SZHSKS-së.

6.3.5 Monitorimi dhe raportimi

Ekipi i IMRT-së do të bëjë monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SZHSKS-së, bazuar në një sistem të rregullt monitorimi dhe raportimi. Progresi do të ndiqet bazuar në dy grupe raportesh.

- a. I pari do të jetë një raport gjashtëmujor dhe njëvjetor, që do të mbulojnë progresin ndaj secilit element të Planeve të Veprimit. Secili institucion do të përgatisë një raport mbi progresin në lidhje me përkushtimin e vet në Planet e Veprimit; raportet do të theksojnë progresin, njohë shmangiet nga plani, identifikojë arsyet dhe propoziojë e veprimet korrektuese. Këto raporte do t'i bëhen për njësinë organizative të përcaktuar në INSTAT (shih 6.3.2 Ekipi i menaxhimit, më sipër) dhe do të agregohen të gjitha në një raport të përgjithshëm. Raporti gjashtëmujor do të jetë një përmbledhje që do të mbulojë elementët kyç të SZHSKS-së dhe do t'u jepet pjesëmarrësve në SZHSKS dhe Bordit Këshillimor. Raporti vjetor do të jetë një raport gjithëpërfshirës që do t'u jepet pjesëmarrësve në SZHSKS dhe Bordit Këshillimor dhe duhet t'i prezantohet Parlamentit, bashkë me komentet e Bordit Këshillimor. Detajet e përmbajtjes dhe formës së raportit do të zhvillohen nga INSTAT-i në konsulencë me statistika-prodhuesit dhe me Bordin Këshillimor.
- b. Raporti i dytë do të jetë i bazuar në raportin vjetor bazuar në një grupi Indikatorësh të propozuar të Performancës (TP). TP-të do të kenë synime afatshkurtra që lidhen me to - 2021 dhe 2023. Qëllimet për vitet pas 2023 do të vendosen në një fazë më të vonë (gjatë Rishikimeve të ndërmjetme dhe finale (shih 6.3.7 Rishikimi dhe Vlerësimi më poshtë) dhe do të pasqyrojnë natyrën afatgjatë të Objektivave (deri në 2030). Gjithashtu, TP-të do të rishikohen në atë segment kohe për rëndësinë e tyre të vazhdueshme, ndërsa mund të shtohen edhe TP të tjerë nëse do të lindë nevoja. TP-të do të mundësojnë monitorimin e progresit progres drejt objektivave.. INSTAT-i do të jetë përgjegjës për përpilimin e TP-ve bazuar në raportet nga secili institucion dhe burime të tjera. Ky raport duhet të rishikohet nga Bordi Këshillimor në SZHSKS dhe duhet t'i paraqitet Parlamentit bashkë me komentet e Bordit Këshillimor. Raportet, bashkë me komentet e Bordit Këshillimor, duhet të vendosen në faqen e internetit të INSTAT-it.

6.3.6 Indikatorët e Performancës

TP-s të propozuar janë renditur në tabelën më poshtë sipas i) secilit prej 6 Objektivave të përcaktuar në Kreun 5 Kuadri Strategjik i propozuar për SZHSKS, më sipër (32 TP); ii) Strategjive që zbatohen për një grup objektivash (5 TP); dhe iii) kosto-efektivitetit të iniciativave (4 TP).

Disa nga Indikatorët janë unikë për Shqipërinë dhe SZHSKS-në; të tjerë kanë zbatueshmëri të më gjërë në NSDS-të eshteteve (National Strategies for the Development of Statistics-Strategjitë Kombëtare për Hartimin e Statistikave/shën.përkth.). Lista përfshin Indikatorët e Vlerësimit të Performancës që INSTAT-i përdor aktualisht në procesin e tij të planifikimit dhe monitorimit³⁹, por të përcaktuar për t'u lidhur me SKS-në.

Për secilin prej treguesve që do të duhet të monitorohet progresi duhet të përcaktohen vlerat baze fillestare për vitin 2012 dhe vlerat që kërkohen të arrihen për vitin 2023. Këto do të zhvillohen gjatë vitit të parë të SZHSKS-së nga INSTAT-i në këshillim me SKS-në.

Burimet e të dhënave për të përlogaritur/verifikuar vlerat e TP-ve mund të përfshijnë, sipas rastit, raportet nga prodhuesit, të agreguara nga INSTAT-i, anketa të kënaqësisë së përdoruesve, vëzhgime të medias nga INSTAT-i, vëzhgime të Bankës Botërore, FMN-së dhe Open Data Watch, faqet e internetit nga INSTAT-i, raportet, publikimet dhe produkte të tjera.

³⁹ Plani Vjetor 2019 i INSTAT-it, faqet 23, 24

Tabela 2 : Indikatorët e performancës

Indikatorët në *italik* aktualisht janë përdorur nga INSTAT-i në kontekstin e Planit Vjetor 2019 të INSTAT-it.

Viti dhe të vlerë bazë do të varen nga disponueshmëria e të dhënave për secilin nga indikatorët.

Indikatorët e performancës	Viti dhe vlera bazë	Synimi deri në 2021	Synimi deri në 2023
1 Të zhvillohet SKS për të qënë në prapthje të plotë me acquis communautaire në statistikë dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit evropian (3 tregues)			
<i>Numri i të dhënave të raportuara të shfaqura në databazën statistikore të Eurostat-it për Shqipërinë</i>			
Numri i ligjeve, rregullave dhe procedurave të reja të ndryshuara,			
Numri i rekomandimeve të zbatuara			
2 Të plotësohet niveli i plotë i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare (12 tregues)			
<i>Numri i publikimeve të reja të botuara gjatë një viti kalendarik, sipas Kalendarit të Publikimeve</i>			
<i>Numri i indikatorëve të rinj të prezantuar në botimet ekzistuese sipas Kalendarit të Publikimeve</i>			
<i>% e produkteve të përfshira në Kalendarin e Publikimit Paraprak që janë publikuar në kohë</i>			
Numri i burimeve të reja administrative të përdorura si prurje për statistikat			
% e produkteve të botuara në përputhje të plotë me FMN (e-GDDS)			
<i>Numri i vizitave në faqen e internetit të SKS</i>			
% e përdoruesve që shprehen të kënaqur me sasinë dhe detajimin e të dhënave të disponueshme (në një Anketë)			
% e përdoruesve që tregon se qasja në të dhënat është "e lehtë" (në një Anketë)			
Renditja në klasifikimin e Open Data Watch			
Numri i ndërveprimeve me përdoruesit (mbledhjet me grupin e përdoruesve, etj.)			
% e indikatorëve për SKZHI të dhëna sipas specifikimeve			

Indikatorët e performancës	Viti dhe vlera bazë	Synimi deri në 2021	Synimi deri në 2023
% e treguesve të OZHQ-së të propozuar për t'u përpiluar nga SKS, që aktualisht përpilohen sipas specifikimeve			
3 Të prodhohen gjithë statistikat zyrtare me një nivel të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuar evropiane dhe ndërkombëtare (4 indikatorë)			
% e domeneve/serive statistikore për të cilat janë zbatuar klasifikime statistikore ndërkombëtare			
Numri i raporteve të cilësisë të publikuara			
Numri i auditeve të kryer			
% e përdoruesve që janë të kënaqur me cilësinë e statistikave (në një Anketë)			
4 Të përfshihen institucione statistika-prodhues shtesë në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare (3 indikatorë)			
Numri i institucioneve që i janë shtuar PKZHS-së			
Numri i institucioneve që marrin pjesë në një listë të integruar vjetore të anketave statistikore			
Numri i institucioneve pjesëmarrëse në SZHSKS			
5 5. Të modernizohen më tej proceset, metodat, produktet dhe shërbimet statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efikasitetin në kosto të statistikave zyrtare (5 indikatorë)			
<i>Numri i aktiviteteve statistikore të dokumentuara/përditësuara duke përdorur Modelin e Përgjithshëm të Procesit Statistikor të Biznesit (GSBPM)</i>			
<i>Numri i aktiviteteve të kryera para planifikimit në një vit kalendarik krahasuar me periudhën e kërkuar nga rregulloret e Eurostat-it.</i>			
Numri i iniciativave TIK të ndërmarra në lidhje me proceset e produktit statistikor.			
Numri i manualëve të rinj/të përditësuar të publikuar			
Kohore mesatare e vonesës së kryerjes së një ankete dhe daljes së rezultateve			
6 6. Rritja e besimit të lartë publik në SKS dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur			

Indikatorët e performancës	Viti dhe vlera bazë	Synimi deri në 2021	Synimi deri në 2023
(5 indikatorë)			
% e përdoruesve që shprehin besim/siguri në statistikat kombëtare (në një Anketë)			
% e përdoruesve që shprehin perceptim pozitiv rreth cilësisë së të dhënave (në një Anketë)			
Numri i përdorimit si referim i produkteve të SKS-së në media, p.sh., në gazetatat ditore kryesore ose në televizione			
Renditja e Shqipërisë në Indikatorin e kapacitetit Statistikor të Bankës Botërore			
Numri i aktiviteteve të kryera për ndërgjegjësimin/mbrojtjen			
Strategjitë që zbatohen në një grup objektivash- Burimet njerëzore, nismat TIK (5 indikatorë)			
% e personelit shtesë aktualisht dhe që deklarohet si i domosdoshëm për zbatimin e SZHSKS-së që është shtuar aktualisht			
Numri i javëve të trainimit në vit që ka marrë çdo anëtar i personelit			
% e personelit me gradën Bachelor ose me gradë më të lartë në statistikë ose fusha të ngjashme			
% e personelit me njohuri në TIK Bazë Të avancuara			
Numri i seminareve ose aktiviteteve të ngjashme ku është marrë pjesë me organizata kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare			
Vëmendja ndaj efijencës në kosto (4 indikatorë)			
% e personelit që ka marrë çdo vit një modul kualifikimi mbi efijencën në kosto			
<i>Numri i aktiviteteve statistikore të përfshira në procesin e auditimit statistikor</i>			
<i>Numri mesatar i ditëve të punës për person për prodhimin e aktiviteteve prodhuese/statistikore</i>			
<i>Numri i aktiviteteve që kanë ndikuar në pakësimin e ditëve të prodhimit ku përfshihen procese statistikore</i>			

6.3.7 Rishikimi dhe vlerësimi

Bordi Këshillimor do të rishikojë çdo vit progresin në Planin e Veprimit, bazuar në raportet e monitorimit. Në fund të çdo viti, Planet e Veprimit do të shtrihen edhe për një vit tjetër, në mënyrë që hapësira e planifikimit të jetë gjithmonë 4 vjeçar.

Në fund të vitit të dytë të Planeve të Veprimit do të bëhet edhe një Vlerësim i Ndërmjetëm i SZHSKS-së; kjo mund të bëhet së brendshmi ose edhe me anë të një konsulence të jashtme. Do të bëhen rekomandime për çfarëdo ndryshimi thelbësor që i duhet SZHSKS-së në dritën e ndryshimeve në mjedisin statistikor dhe progresin kundrejt Planeve të Veprimit.

Është propozuar po kështu edhe një Vlerësim Përfundimtar, nga ku do të nxirren mësimet për një plan të ri strategjik, duke marrë parasysh edhe ndryshimet në mjedisin statistikor dhe progresin kundrejt Planeve të Veprimit. Edhe ky vlerësim mund të bëhet gjithashtu së brendshmi ose edhe me anë të një konsulence të jashtme.

Kapitulli 7

Menaxhimi i Riskut

7.1 Risqet e identifikuara në analizën SWOT

Mes tyre ka kërcënime që janë pikasur në analizën SWOT sa më sipër, që lidhet me SKS-në. INSTAT duhet të ndërmarrë veprime, ku ka mundësi, për t'i zvogëluar këto risqe. Risqet dhe veprimet e mundshme për t'i zvogëluar ato, janë renditur më poshtë.

- i) **Risk: afate kohore të dorëzimit dhe plotësimii të dhënash jo adeakuete**, gjë që mund të ndikojë në dorëzimin dhe plotësimin në kohë të statistikave zyrtare dhe në rënien e besimit të qeverisë dhe atij publik në statistika, si dhe rrezikon nivelin e mbështetjes dhe financimit të punës statistikore.

Veprim: INSTAT-i duhet i) të vazhdojë të lidhë Memorandume Mirëkuptimi me furnizuesit dhe mbajtësit e RA-ve; ii) të bëjë rregullisht mbledhje me institucionet për të kuptuar çështjet dhe problemet që mund të kenë; iii) të përgatitet për të qenë pjesë e zgjidhjes për disa çështje, p.sh., mbështetje TIK, mbështetje metodologjike; iv) të mbajë kontakt në nivel teknik dhe në nivelet ekzekutive për të garantuar mbështetje në nivel të lartë që të ketë shkëmbim të dhënash; v) të kërkojë vazhdimisht burime shtesë/alternative të të dhënave, të cilat mund të shërbejnë për të njëjtin qëllim.

- ii) **Risk: Mungesa të burimeve të mjaftueshme financiare dhe të personelit** mund të ndikojnë në aftësinë për të kryer në kohë censuse dhe anketa dhe për të zbatuar një program statistikor të besueshëm me cilësi të lartë.

Veprim: INSTAT duhet i) me këmbëngulje ta bëjë çështje qeveritare që statistikën janë thelbësore për hartimin e politikave dhe për monitorimin e efektivitetin e politikave; ii) të garantojë që INSTAT të ketë një profil të lartë publik përmes përdorimit të të gjithë mediave në dispozicion, si dhe mundësive profesionale; iii) të mbajë kontakt me kolegë zyrtarë të nivelit të lartë në pozicione financiare dhe politikash dhe me institucionet statistika-prodhues (p.sh., të ofrojë pjesëmarrje dhe mbështetje në programet e tyre profesionale të zhvillimit) për të vazhduar dialogun me ta rreth rëndësisë së statistikave.

- iii) **Risk: Shkalla e lartë ndërrimi të personelit** mund të reduktojë nivelet ekzistuese të eksperience dhe ekspertizës, vazhdimësinë, si dhe njohuritë institucionale, të cilat së bashku kanë një rëndësi kyçe për prodhimin e statistikave dhe mbërritjen te përdoruesi.

Veprim: i) të ndërmerren gjithë hapat për të bërë karrierë në statistika, duke u bërë thirrje të diplomuarve rishtas; ii) të ndërmerren të gjithë hapat për të mbështetur interesin e personelit në karrierën e statistikave, duke ofruar një punë sfiduese dhe përpjesëtim të drejtë shpërblimesh për performancën.

- iv) **Risk: Mund që të ndodhin ndryshime në strukturat organizative për organizatat statistika-prodhuese** dhe si pasojë, mund bëhen edhe marrëveshje më pak të favorshme në lidhje me statistikën.

Veprim: i) të shfrytëzohen mundësitë për të mbështetur sa më shumë të jetë e mundur një strukturë organizative të përshtatshme dhe të qëndrueshme për statistikën në institucionet statistika-prodhuese; ii) të përgatitet një dokument (position paper) për nevojën e një njësie organizative të identifikuar,

përgjegjëse për statistikën dhe të drejtohet dhe plotsohet nga statisticienë profesionistë, si edhe të shfrytëzojë çdo mundësi që të shpërndajë këtë dokument.

- v) **Risk: Përdorimi jo korrekt dhe keqkuptimi i të dhënave statistikore të publikuara** mund të krijojë perceptime negative për institucionet e SKS-së dhe mund të çojë në mungesë besimi për statistikën e publikuara.

Veprim: INSTAT dhe institucione të tjera statistika-prodhues duhet të reagojnë ndaj shpërdorimit dhe keqkuptimit të identifikuar të të dhënave statistikore të publikuara me anë të konferencave për shtyp për të gjitha llojet e medias; ii) të përfshihet në analiza dhe të publikojë këto analiza në media ose në hulumtime shkencore; iii) të zhvillojnë module për prezantim në gjithë nivelet e arsimit për të fuqizuar njohuritë bazë rreth statistikave.

- vi) **Risk: Mungesa e fakulteteve që diplomojnë statisticienë** pakëson disponueshmërinë e kandidatëve me arsimin e përshtatshëm për karrierë në statistika, gjë që sjell efekte afatgjata në cilësinë e forcës së punës, duke bërë që INSTAT të angazhohet në një gamë më të gjerë aktivitetesh edukimi për të plotësuarohen boshllëqet.

Veprimi: Të bashkëpunojë me institucionet e edukimit tretësordhe mbështesë procesin e hapjes së kurseve të ciklit të parë në statistika ose në module statistikore, të cilat mund të bëhen pjesë e një game të gjerë programesh studimi.

7.2 Risqet shtesë

- i) **Risk: Mbështetja e Partnerëve për Zhvillim mund të ndërpritet ose të reduktohet**, duke hequr një pjesë të rëndësishme të financimit për statistikën dhe duke vënë në rrezik qëndrueshmërinë e programeve statistikore.

Veprimi: INSTAT-i dhe organizatat statistika-prodhues duhet i) të mbajnë kontakte të ngushta me Partnerët e tyre tradicionalë për Zhvillim dhe të ngrenë kanale komunikimi me Partnerët të rinj; ii) të sigurojnë suksesin e projekteve dhe programeve që mbështeten nga Partnerët për Zhvillim; të kërkojnë mbështetjen e Partnerëve për Zhvillim për komponentë të rëndësishëm të SZHSKS-së.

- ii) **Risk: personeli që punon me statistikën mund të mos ketë marrë arsimin dhe kualifikimin e përshtatshëm** dhe si rezultat stafi i ekipit nuk do të jetë i mirë-përgatitur për t'u përballur me kërkesat aktuale statistikore dhe ato që mund të shfaqen më vonë.

Veprimi: INSTAT-i të i) vazhdojë të zhvillojë Qendrën e Trajnimit dhe Programin e Trajnimit, duke i vënë ato në dispozicion të të gjithë institucioneve statistika-prodhues (dhe të të tjerëve që mund të përfitojnë prej tyre); ii) krijojë një kërkesë standarde (e rekomanduar kjo) për trajnimin statistikor të personelit.

- iii) **Risk: Mund të ndodhin vonesa në zbatimin e ndryshimeve organizative në institucionet statistika-prodhues për të krijuar njësi të vecantë të dedikuara statistikore të drejtuar nga statisticienë profesionistë.** Këto vonesa do të pengojnë operacionet dhe zhvillimet statistikore të mirë-organizuara.

Veprimi: INSTAT të i) shfrytëzojë mundësinë të mbështesë sa më shumë të ketë mundësi ndryshimin organizativ për statistikën në institucionet statistika-prodhues; ii) të përgatitet një dokument (position paper) për nevojën e një njësie organizative të identifikuar, përgjegjëse për statistikën dhe të drejtohet dhe

e kompletet me personel statisticienë profesionistë dhe të shfrytëzohet çdo mundësi që të shpërndalet ky raport (si në Riskun iv më sipër).

Kapitulli 8

Shtojcat

8.1 Shtojca I: Rekomandime nga vlerësimet e Sistemit Kombëtar të Statistikave, prodhues të tjerë statistikash dhe mbajtësit e rekordeve administrative

Vlerësimi i Sistemit Kombëtar Statistikor

A. Plotësimi i nevojave të përdoruesit

- 1 Treguesit për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit dhe Integritimit (SKZHI) 2015-2020
INSTAT-i dhe MFE të krijojnë një plan për të garantuar prodhimin e të gjithë treguesve të SKZHI-së për të cilët ata janë përgjegjës, por që nuk i kanë prodhuar ende.
- 2 Zbatimi i *acquis communautaire* në statistika
INSTAT-i të vazhdojë zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi "Peer Review" dhe progres-raportet e BE-së.
- 3 Treguesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG)
INSTAT-i të intensifikojë bashkëpunimin me ministritë e linjës, agjencitë përkatëse, të përcaktojnë mundësitë për të prodhuar më shumë indikatorë OZHQ.
SKS t'u japë prioritet më të lartë planeve dhe prodhimit statistikor, disagregimeve të përmendura në kontekst të Indikatorëve OZHQ dhe disagregimeve të tjera që mund të jenë të rëndësishme për Shqipërinë.
SKS të përcaktojë se cilat burime duhen për të mbështetur hartimin dhe prodhimin e treguesve dhe të planifikojë mënyrat për t'i bërë të disponueshme këto burime, duke u bazuar në punën e INSTAT-it në identifikimin e burimeve të të dhënave për treguesit.
- 4 Plotësimi i kërkesave kryesore të vazhdueshme për statistikat
INSTAT-i të rishikojë rregullisht kërkesat për treguesit dhe të caktojë prioritetet të qarta dhe një kuadër kohor brenda të cilit mund të plotësohen këto kërkesa, me synim pakësimin e përqindjes së përdoruesve të cilët kanë gjykuar se të dhënat e INSTAT-it nuk përmbushin nevojat e tyre dhe kanë qenë të pakënaqur me numrin e statistikave në dispozicion.
INSTAT-i t'u japë të dhënave të disagreguara prioritet më të madh në planet dhe prodhimet statistikore.
- 5 Mikrodata
INSTAT-i të mirëmbajë të dhëna mbi përdorimin e mikrodatave dhe ndonjë produkti tjetër si bazë për të informuar vendimet e ardhshme të politikave mbi vënien në dispozicion të mikrodatave.
INSTAT-i të anketojë përdorues aktualë dhe potencialë të mikrodatave në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre në grupe shtesë mikrodatash, duke ua vënë këto në dispozicion.
- 6 Angazhimi me përdoruesit/procesin konsultues
SKS të intensifikojë komunikimin me përdoruesit dhe në veçanti i) të kuptojë pritshmëritë e tyre dhe ii) të përmirësojë aftësinë e tyre për të gjetur, kuptuar dhe përdorur statistikat.

7 Shpërndarja

INSTAT-i të zbatojë plotësisht " Politikën e Shpërndarjes së të Dhënave të INSTAT-it dhe Udhëzuesin, 2018, si dhe Raportin e INSTAT-it për Strategjinë e Shpërndarjes, Janar 2018.

8 Ndërgjegjësimi dhe avokimi statistikor

INSTAT-i të ndërtojë një program publiciteti për INSTAT-in si një institucion, bazuar në përgatitjet për Censin e Popullsisë dhe Banesave, që është një sipërmarrje kombëtare e një niveli të lartë dhe shumë e publikuar.

INSTAT-i të paraqesë para medias një herë në gjashtë muaj ose një herë në vit atë që po bën në lidhje me procesin e integritetit në BE, duke përfshirë edhe sukseset më të dukshme; puna e INSTAT-it kontribuon në shumë fusha të integritetit.

B. Çështje të prodhimit të statistikave

1. Burimi i të dhënave

1.2 Rekordet administrative

Të organizohen mbledhje, seminare, konferenca, etj., për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë së të dhënave administrative.

Të rishikohen në mënyrë metodike cilësia e të dhënave administrative në dispozicion, të identifikohen problemet dhe të ngrihet një plan i aktiviteteve për përmirësim.

Të vazhdojë kërkimi i rekordeve të përshtatshme administrative si një bazë për statistikat.

Të punohet me mbajtësit e RA-ve për të identifikuar dhe shfrytëzuar çdo RA në dispozicion që mund të përdoret për të gjeneruar statistika, përfshirë edhe ndonjë ndihmë që INSTAT-i mund të ofrojë në këtë proces.

Të punohet me mbajtësit e të dhënave administrative për të përmirësuar cilësinë e të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Të zhvillohet një manual ose udhëzues mbi sigurimin e cilësisë së të dhënave administrative për qëllime statistikore (një kuadër i sigurimit të cilësisë për të dhënat administrative) dhe t'u jepet ndihmë mbajtësve të të dhënave administrative ta zbatojnë atë.

Të përgatitet një kurrikulum trainimesh dhe të ofrohet kualifikim për sigurimin e cilësisë së të dhënave administrative.

Të theksohet roli i INSTAT-it në procesin e krijimit dhe rishikimit të sistemeve të të dhënave administrative.

Të përmirësohen regjistrat administrativë dhe përcjellja/dërgimi i të dhënave administrative.

1.3 Burime të tjera të dhënash

SKS duhet të jetë në një hap me zhvillimet ndërkombëtare në përdorimin e burimeve të reja të të dhënave, përfshirë informacionin gjeo-hapësinor, si dhe të jetë e gatshme t'i përshtasë këto burime kur ato të kenë rezultuar/provuar të vlefshme.

2. Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave

3. Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

4. Çështje të cilësisë

INSTAT-i duhet të zgjerojë programin e vet ekzistues të promovimit të cilësisë së sigurisë në institucioneve të tjera statistika-prodhues, si dhe të ofrojë trainime, bazuar në Strategjinë e Zbatimit të Menaxhimit të Plotë të Cilësisë dhe Udhëzimet Cilësore për Proceset Statistikore nga GSBPM Fazat 1 – 8. SKS-ja duhet të vazhdojë të paraqesë përsosje në proceset e tyre dhe në mbështetjen e TIK për të arritur vazhdimisht standardet evropiane të afateve kohore.

5. Metadata

SKS të përgatisë metadata statistikore në përputhje me standardet ndërkombëtare.

C. Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

1. Kuadri ligjor:

INSTAT-i duhet të plotësojë të gjitha masat e nevojshme që Këshilli i Statistikave të funksionojë siç është përcaktuar në Ligjin për Statistikat 2018.

MFE duhet të rishikojë racionalitetin dhe efikasitetin e strukturës organizative në MFE të të pasurit dy Drejtorë të Përgjithshëm që “drejtojnë sektorin statistikor” (Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Borxhit).

2. Kuadri institucional dhe qeverisja

3. Strukturat organizative

4. Praktikat e menaxhimit:

SKS duhet të rishikojë sistemet e veta të menaxhimit dhe monitorimit që janë në fuqi dhe të garantojë se ato e adresojnë përdorimin e burimeve në dispozicion në mënyrën më eficiente dhe efektive për zhvillimet aktuale dhe të pritshme dhe kërkesave operacionale.

D. Çështje të sistemit

1. Fusha/hapësira (the scope) e Sistemit Kombëtar Statistikor

INSTAT-i të përfshijë institucione shitesë statistika-prodhues në Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare.

2. Koordinimi

INSTAT-i duhet të angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në forcimin e bashkëpunimit me institucionet të cilat prodhojnë statistika dhe ose të dhëna administrative.

INSTAT-i duhet të organizojë një Plan Vjetor të Anketave Statistikore që të kryhen nga prodhuesit e statistikave, në mënyrë që të fuqizojë koordinimin e anketave, zbatimin e metodologjive të njësuara dhe shmangien e hyrjeve të dyfishta.

INSTAT-i të nxisë zbatimin e një qasjeje të standardizuar ndaj sigurimit të cilësisë statistikore nga prodhuesit e statistikave.

INSTAT-i duhet të ofrojë mbështetje teknike për prodhuesit e statistikave për të siguruar përputhje të veprimtarive statistikore me standardet ndërkombëtare.

INSTAT-i duhet të përshtasë një qasje të koordinuar më të formalizuar të trainimeve në SKS.

INSTAT-i duhet të zbatojë rekomandimet mbi mbulimin, mbështetjen, menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin, rishikimin dhe vlerësimin në SZHSKS, siç është përcaktuar në Kreun 6. Menaxhimi i SZHSKS-së, që mbi të gjitha do të kontribuojë në koordinimin e përmirësuar të SKS-së.

3. Besueshmëria të statistikave

INSTAT-i duhet të publikojë Angazhimin për Rritjen e Besimit të Statistikave të Qeverisë Shqiptare, 2017 në faqen e internetit të INSTAT-it dhe ta shpërndajë atë në të gjitha aktivitetet publike të organizuara nga institucionet e SKS-së.

4. Konfidencialiteti

SKS-ja duhet të sigurojë që institucionet e veta zbatojnë procedura të krahasueshme dhe efektive për konfidencialitetin.

5. Roli i Partnerëve për Zhvillim

INSTAT-i duhet të vazhdojë të thërrasë rregullisht mbledhje koordinimi mes INSTAT-it dhe Partnerëve për Zhvillim, siç është rënë dakord dhe është planifikuar nga INSTAT-i dhe donatorët dhe të ketë përherë fleksibilitetin të mblidhen ad hoc.

E. Burimet

1. Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

Në prag të ndryshimeve domethënëse dhe risise së mjedisit statistikor, INSTAT-i duhet të nisë në SKS një program të llojit “ndrysho menaxhimin”, , për të mbështetur personelin në pranimin e ketij ndryshimi, përshtatjes me të dhe shfrytëzimin e tij për kënaqësinë dhe motivimin e tyre personal dhe në përfitim të SKS-së.

INSTAT-i duhet të zhvillojë më tej programin e vet të trainimit, ku të përfshijë prodhuesit e tjerë të statistikave dhe mbajtësit e RA-ve.

2. Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

INSTAT-i duhet të zhvillojë një Sistem TIK për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve të SKS-së.

3. Infrastruktura Statistike

Regjistrat e bizneseve dhe familjeve

INSTAT-i duhet të zbatojë Udhëzimet e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën për përdorimin e regjistrave statistikore të biznesit për demografinë e biznesit dhe për statistikën sipërmarrjeve (Janar 2019)

4. Buxheti për statistikën

5. Financimi për statistikën

Vlerësimi i institucioneve statistika-prodhues

A. Plotësimi i nevojave të përdoruesit

1. Përbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave

2. Statistikat e disagreguara (statistikat nën-kombëtare dhe disagregime të tjera)

Shih rekomandimet e para të A.1. Përbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave, këtu sipër.

3. Shpërndarja

Të zgjerohet përdorimi i faqeve të internetit për shpërndarjen e statistikave.

B. Çështje të prodhimit të statistikave

1. Burimi i të dhënave

2. Grumbullimi, procesimi dhe analizimi i të dhënave

Të përmirësohen proceset statistikore me anë të zbatimit të GSBPM dhe të shtrirjes së mbështetjes së përditësuar të TIK.

Të zhvillohen manualët e nevojshëm për të gjitha pjesët e procesit statistikor dhe përgatitja për metadat, duke kërkuar mbështetje teknike nga INSTAT-i, ku shihet e nevojshme.

3. Aplikimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

Të identifikohen dhe të zbatohen konceptet, përkufizimet, klasifikimet dhe praktikët ndërkombëtare që mund të jenë me rëndësi për statistikën. INSTAT-i të punojë me institucionet për të nxjerrë rekomandime të rëndësishme dhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre.

4. Çështje të cilësisë

Të aplikohet një platformë e përshtatshme e sigurimit të cilësisë për statistikat, duke përfutur nga puna e bërë në këtë fushë nga INSTAT-i mbi Menaxhimin e Përgjithshëm të Cilësisë dhe Udhëzimet e Cilësisë, si dhe të zhvillohet një plan për të paraqitur përmirësimet.

Të përgatiten dhe të nxirren raporte mbi cilësinë e statistikave për shpërndarje në publik.

5. Metadata

Të prodhohen metadata të përshtatshme për gjithë grupet e statistikave, duke përdorur një sistem metadatash të konsoliduar e standardizuar, si dhe të garantohet që metadata të shoqërojnë statistikat kur ato t'i ofrohen përdoruesit.

C. Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

1. Kuadri ligjor

2. Funksionet dhe strukturat organizative

Të prezantohen ndryshimet organizative që mbështesin aktivitetet statistikore, duke ngritur njësi organizative të specializuara për statistikat.

D. Çështje të sistemit

1. Konfidencialiteti

2. Roli i Partnerëve për Zhvillim

Partnerëve për Zhvillim t'u bëhen propozime specifike për ndihmë në përmirësimin e statistikave.

E. Burimet

1. Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

Të rishikohen nevojat për trajnim dhe zhvillim të personelit; të bëhet një deklaram specifik nevojash dhe të kërkohet nga INSTAT-i udhëzim dhe asistencë në përfundimin e trajnimit të identifikuar.

2. Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Të zhvillohet një plan për zëvendësimin e TIK të vjetëruar dhe të papërshtatshëm, duke përfshirë në të kërkesat për mbështetje të Partnerëve për Zhvillim.

3. Infrastruktura statistikore

F. Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet

G. Të dhëna administrative në dispozicion

Të sillen në vëmendje të INSTAT-it RA-të në dispozicion për të rishikuar potencialin e tyre nëse mund të shërbejnë për qëllime statistikore.

Vlerësimi i institucioneve që janë ofrues të të dhënave administrative për qëllime statistikore

A. Plotësimi i nevojave të përdoruesit

1. Përbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave

Përmirësimi i RA-ve të disponueshme në terma cilësie, detajesh (disagregimi), dorëzimi në kohë dhe mbulimi.

Të punohet me INSTAT-in për të identifikuar dhe shfrytëzuar RA-të e mundshme që mund të përdoren për të gjeneruar statistika, përfshirë edhe identifikimin e ndonjë ndihme të mundshme që mund të nevojitet nga INSTAT-i në këtë proces.

Të përfshihet INSTAT-i në procesin e krijimit dhe rishikimit të sistemit të të dhënave administrative.

Të përfshihen kërkesat statistikore në projektimin e sistemeve të të dhënave administrative.

2. Statistikat e disagreguara (statistikat lokale dhe disagregime të tjera)

Shih rekomandimet e para të A.1. Përmbushja e kërkesave të vazhdueshme kryesore të statistikave, më sipër.

3. Shpërndarja

B. Çështje të prodhimit të statistikave

1. Burimet e të dhënave

Të zhvillohen manuale që të zbatohen për grumbullimin dhe përpunimin e RA-ve.

Sa të jetë e mundur, të përdoren identifikues të zakonshëm në rekorde, nga burime të ndryshme të dhënash.

2. Zbatimi i standardeve, koncepteve, përkufizimeve dhe klasifikimeve ndërkombëtare

Të identifikohen dhe zbatohen koncepte, përkufizime, klasifikime dhe praktika ndërkombëtare, që mund të rezultojnë me rëndësi për variablat në RA për qëllime statistikore. INSTAT-i të punojë me mbajtësit e RA-ve për të identifikuar rekomandime të mundshme dhe të ndihmojë në zbatimin e tyre.

3. Çështje të cilësisë

Të punohet me INSTAT-in për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e të dhënave administrative për qëllime statistikore.

Të përgatiten dhe të nxirren raporte për cilësinë e të dhënave administrative për qëllime statistikore dhe të zhvillohen rekomandime për përmirësimin e cilësisë.

4. Metadata

Të përgatiten metadat e përshtatshme për gjithë grupet e të dhënave administrative dhe të sigurohet se ato do të shoqërojnë këto grupe kur t'u ofrohen përdoruesve.

C. Kuadri ligjor, institucional dhe organizativ

D. Çështje të sistemit

1. Konfidencialiteti

2. Roli i Partnerëve për Zhvillim

T'u bëhen propozime Partnerëve për Zhvillim për asistencë në përmirësimin e të dhënave administrative për qëllime statistikore.

E. Burimet

1. Personeli, trajnimi dhe zhvillimi

Të rishikohen nevojat për trajnimin e personelit dhe zhvillimin në të gjitha pjesët e procesit të përpilimit të të dhënave administrative, me vëmendje të veçantë ndaj kërkesave specifike për qëllime statistikore; të zhvillohen përcaktime specifike të nevojave; dhe të kërkohet nga INSTAT-i udhëzim dhe asistencë në përfundimin e trajnimeve të kërkuara.

2. Infrastruktura fizike dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

F. Kufizimet kryesore/problemet dhe zgjidhjet

8.2 Shtojca II: Procesi i Vlerësimit

Procesi i vlerësimit përfshiu si vijon:

1 Rishikimin e dokumentacionit/rishikimin e vlerësimeve të mëparshme

- 2 Përditësim dhe pasurim të vlerësimeve të mëparshme - rishikim të Pyetësorëve të Vetëvlerësimit Fillestar plotësuar nga INSTAT-i, BSH dhe MFE për vlerësimin *Peer Review* 2018
- 3 Seri konsultash me palët e interesuara
- 4 Pyetësorë Shtesë të përgatitur për plotësim nga INSTAT, BSH dhe MFE
- 5 Pyetësorë dhe intervista personale me institucione të tjera që prodhojnë statistika (17 institucione, renditur më poshtë) ose ofrojnë të dhëna administrative si bazë për të prodhuar statistika (21 institucione, renditur më poshtë).
- 6 Një anketë të faqeve të internetit të INSTAT-it dhe të ministrive e institucioneve për përmbajtjen, afatet kohore dhe teknologjinë
- 7 Rezultatet e anketës së kryer nga INSTAT-i (Projekti SALSTAT - Anketa e Institucioneve)
- 8 Analizë e operacioneve nëpër institucione dhe krahasimi me standardet dhe praktikat ndërkombëtare
- 9 Seminar në 29 maj 2019 për të rishikuar draftin e parë të Vlerësimit
- 10 Seminare në 15 dhe 17 korrik për të riparë një draft të rishikuar të vlerësimit (propozime për Kuadrin Strategjik të SZHSKS-së dhe propozime për menaxhimin e SZHSKS-së)

Në vlerësim u mbuluan 17 institucione statistika-prodhues, siç vijon⁴⁰:

- 11 Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
- 12 Drejtoria për Azilin dhe Shtetësinë
- 13 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
- 14 Ministria e Kulturës
- 15 Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- 16 Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- 17 Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- 18 Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
- 19 Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- 20 Instituti i Shëndetit Publik
- 21 Këshilli i Lartë i Drejtësisë
- 22 Ministria e Drejtësisë
- 23 Bashkia Tiranë
- 24 Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- 25 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
- 26 Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- 27 Shërbimi Social Shtetëror

Në vlerësim u mbuluan 21 institucione që ofrojnë rekorde administrative si bazë për prodhimin e statistikave, si më poshtë:

- 28 Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
- 29 Drejtoria për Azilin dhe Shtetësinë
- 30 Qendra Kombëtare e Biznesit
- 31 Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

⁴⁰ Paraqitur në rend alfabetik sipas fushës së përgjegjësisë së institucionit.

- 32 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- 33 Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit
- 34 Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- 35 Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- 36 Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- 37 Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- 38 Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale
- 39 Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- 40 Instituti i Shëndetit Publik
- 41 Bashkia Tiranë
- 42 Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- 43 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
- 44 Prokuroria e Përgjithshme
- 45 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor
- 46 Shërbimi Social Shtetëror
- 47 Operatori i Sistemit të Transmetimit
- 48 Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

8.3 Shtojca III. Referencat

- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit (NSDI) 2015-2020, Shqipëria
- Progres-Raporti për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integritimin 2015-2020 Maj 2016
- Progres-Raporti për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integritimin 2015-2020 Prill 2019
- Plani Kombëtar për Integritimin Evropian 2017-2020, i Janarit 2017 (Raport mbi progresin)
- Plani Kombëtar për Integritimin Evropian 2017-2020 (pa datë, por mendohet të jetë i Janarit 2018) (Raport mbi progresin)
- Raport mbi Harmonizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm me Politikën Ekzistuese Sektoriale, 30 janar, 2018
- Raportimi Kombëtar Vullnetar mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Qershor 2018
- Raporti "Peer Review" për Përputhshmërinë me Kodin e Praktikës dhe Rolin Koordinues të Institutit Kombëtar të Statistikave, Qershor, 2018
- Progres-Raportet e BE-së për Integritimin Evropian të Shqipërisë, (2019, 2018, 2016, 2015, 2014)
- Rishikimi Sektorial i Zbatimit të Anketës për Forcën e Punës në Shqipëri, Tetor, 2016
- Përshkrim i detajuar i Sistemit Kombëtar Statistikor (dokumenti i padatur i INSTAT-it, por nënkuptohet se është i mesvitet 2018)
- Udhëzuesit dhe Politika e Shpërndarjes së të Dhënave 2018
- Raporti për Strategjinë e Shpërndarjes i INSTAT-it, Janar, 2018
- Raporti Vjetor i INSTAT-it, 2018
- Rregullorja për "Qasjen në mikrodata" të INSTAT-it, 2018
- Pyetësi i Vetë-vlerësimit për Rolin e Koordinimit të INSTAT-it si IKS (NSI) (Peer Review-të për Vendet e Zgjerimit) 2018
- Pyetësi i vetëvlerësimit të INSTAT-it për zbatimin e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (Peer Review-të për Vendet e Zgjerimit) 2018
- Anketa Shtesë e INSTAT-it, 8 Prill 2019
- Konsultime me INSTAT-in gjatë periudhës 27 Mars–2 Prill
- Strategjia e Zhvillimit të INSTAT-it 2017-2030, shtator 2017
- Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021, shkurt, 2017
- Banka e Shqipërisë, pyetësor vetëvlerësimi për zbatimin e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (Peer Review-të për Vendet e Zgjerimit) 2018
- Pyetësi Shtesë i Bankës së Shqipërisë, 8 Prill 2019

- Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë 2017
- Pyetësi i lehtë i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë për zbatimin e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (*Peer Review*-të për Vendet e Zgjerimit) 2018
- Pyetësi Shtesë i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, 9 prill 2019
- Pyetësi i INSTAT-it për të vlerësuar situatën në statistikat qeveritare në Shqipëri - Institucionet statistika-prodhues, 6 Prill
- Pyetësi i INSTAT-it për të vlerësuar situatën në statistikat qeveritare në Shqipëri – Mbajtësit e rekordeve administrative në databaza, 8 Prill
- Sintezë e vlerësimeve të mëparshme, 20 Mars 2019 (GOPA Consultants)
- Rezultatet e anketave - Anketa për Projektin e Statistikave të Forta Lokale Shqiptare (Projekti SALSTAT) (në INSTAT) e 78 institucioneve në vitin 2018, në një gamë subjektesh që kanë të bëjnë me statistikat, përfshirë edhe të dhënat e INSTAT-it, bashkëpunimi me INSTAT-in, dispozitat e të dhënave administrative ose statistikave dhe struktura organizative për punën statistikore.
- Plani Vjetor 2019 i INSTAT-it për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ) 2017-2021
- Seminar për SZHSKS-në “Vlerësimi i SKS-së dhe Zhvillimi i Kuadrit Strategjik dhe Planeve të Veprimit”; ambientet e INSTAT-it; 29 maj 2019